



A ekziston Zoti? Debat midis një të krishteri dhe ateisti

## Description

### William Lane Craig dhe Massimo Pigliucci

Universiteti i Xhorxhas, Athinë  
1998

William Lane Craig dhe Massimo Pigliucci

Me shënime nga William Lane Craig

[Dr. Craig: Fjalimi hyrës](#)

[Dr. Pigliucci: Fjalimi hyrës](#)

[Dr. Craig: Kundërshtimi i parë](#)

[Dr. Pigliucci: Kundërshtimi i parë](#)

[Dr. Craig: kundërshtimi i dytë](#)

[Dr. Pigliucci: Kundërshtimi i dytë](#)

[Dr. Craig: Përfundimi](#)

[Dr. Pigliucci: Përfundimi](#)

### Fjalimi hyrës i Dr. Craig

Mirëmbërëma! Dua t'ia filloj duke falenderuar Komisionin e Botimeve për ftesën për të marrë pjesë në debatin e mbërmjes së sotme, dhe shpresoj që ky do të jetë një hap domethënës përpara në udhëtimin tuaj shpirtëror.

Duke ngritur çështjen e ekzistencës së Zotit, ne, ç'është e vërteta, angazhohemi në vlerësimin e hipotezave në lidhje me botën, gjegjësisht, hipotezat se Zoti ekziston. Nëse qëllimi ynë është të përcaktojmë logjikisht nëse kjo hipotezë është apo jo e vërtetë, ne duhet ta kryejmë hetimin tonë sipas rregullave themelore të logjikës. Argumentet e bazuara mbi logjikën e pavlefshme, sado emocionalisht tërheqëse që mund të duken, janë të padobishme kur bëhet fjalë për dhënien e ndonjë garancie

racionale në lidhje me konkluzionet e tyre.

Prandaj, ne duhet të shtrojmë dy pyetje sa i përket kësaj hipoteze: (1) Çfarë evidencash ka që mund të shërbejnë për të vërtetuar këtë hipotezë? (1) Ç'evidenca ekzistojnë që shërbejnë për të shtrembëruar këtë hipotezë?

### **Pyetja e dytë**

Sa i përket pyetjes së dytë, unë do t'ia lë Dr. Pigliucci të paraqesë arsyet se përse ai mendon se kjo hipotezë është e rreme. Ateistet janë përpjekur për shekuj me radhë që të hedhin poshtë ekzistencën e Zotit, por asnjëri prej tyre nuk ka arritur të paraqesë një argument të suksesshëm. Dr. Pigliucci, nga ana tjetër, në artikullin e tij "God as a Falsifiable Hypothesis," (Zoti si hipotezë e përgënjeshtroshme) thotë, 'Pikëpamja ime është se besimi në Zot mund të përgënjeshtrohet' mbi bazën e evidencës. (1) Pra në vend të se të sulmoj sharlatanët në këtë pikë, unë thjesht do rri në pritje të përgjigjes së Dr. Pigliuccit ndaj pyetjes vijuese: *Çfarë evidencash të mira ekzistojnë që tregojnë se Zoti nuk ekziston?*

### **Pyetja e parë**

Le të hedhim një vështrim, pra, në pyetjen e parë: Ç'evidenca ekzistojnë që shërbejnë për të vërtetuar ekzistencën e Zotit? Sonte unë do të paraqesë pesë arsye në mbështetje të hipotezave specifike se ekziston një Krijues dhe një Projektues i përveçëm i universit, i cili është vendi i vlerës absolute dhe i cili e ka shfaqur Vetveten të Krishti. Libra pa fund janë shkruar mbi secilën prej këtyre çështjeve, dhe andaj, ajo që unë mund të paraqesë këtu është një skicim i shkurtër i secilit argument dhe mandej të hyj në detaje të mëtejshme, ndërkohë që Dr. Pigliucci u përgjigjet atyre.

### **Argumenti i parë**

*Zanafilla e universit.* A e keni pyetur vallë ndonjëherë veten se prej nga erdhi universi? Përse gjithçka ekziston në vend se thjesht asgjë? Atesitët tipikë kanë thënë se universi është thjesht i përhershëm dhe i pashkak. Por me siguri kjo është e palogjikshme. Mendoni rreth saj vetëm për një minutë. Nëse universi është i përhershëm dhe nuk ka patur kurrë një fillësë, kjo nënkupton se numri i ngjarjeve të shkuara në historinë e universit është e pafundme. Por matematikanët pranojnë se ideja e një numri të pafundëm gjërash shpie në kontradiktë të brendshme. Për shembull, sa bën  $\infty$  minus  $\infty$ ? Me thënë të vërtetën, matematikisht, ju do të merrni përgjigje kontradiktore. Kjo tregon se pafundësia është thjesht një ide në mendjen tuaj, jo diçka që ekziston në realitet. Daiv Hilbert, ndoshta matematikani më i madh i këtij shekulli, deklaroi, "Infiniti nuk mund të gjendet askund në realitet. Ai nuk ekziston as në natyrë dhe as nuk jep një bazë të ligjshme për mendim të arsyeshëm. Infinitit s'i mbetet tjetër veçse të luajë rolin e një ideje." (2) Por kjo do të thotë se meqënëse ngjarjet e shkuara nuk janë thjesht ide, por janë të vërteta, numri i ngjarjeve të kaluara duhet të jetë i fundëm. Rrjedhimisht, seritë e ngjarjeve të kaluara nuk mund të vazhdojnë përjetësisht; më saktë, universi duhet të ketë filluar së ekzistuari.

Ky konkluzion është konfirmuar nga zbulime të shquara në astronomi dhe astrofizikë. Evidenca astrofizike tregon se universi filloi së ekzistuari 15 miliardë vjet më parë në një shpërthim të madh të quajtur "Big Bang". Në atë ngjarje u krijuan koha dhe hapësira fizike, si edhe lënda dhe energjia në univers. Rjedhimisht, siç nxjerr në pah astronomi i Kembrixhit Bred Hoyle, teoria e Big Bangut kërkon që universi të jetë krijuar *prej asgjësë*. Kjo sepse, ndërsa kthehesh në kohë, arrin një pikë në të cilën, me fjalët e Hoyle, universi ishte 'i tkurrur në absolutisht asgjë'. (3) Për pasojë, modeli i Big Bangut

kërkon që universi të ketë filluar së ekzistuari dhe të jetë krijuar nga hiçi. Kjo ka tendencën të jetë shumë pakëndëshme për ateistin. Pasi, siç nxit Anthony Kenny i universitetit të Oksfordit, 'Një ithtar i teorisë së Big Bang-ut, të paktën nëse ai është ateist, duhet të besojë se ...universi ka ardhur nga hiçi dhe prej hiçit. "4 Por natyrisht kjo s'ka kuptim! Prej hiçit, nuk del asgjë. Atëherë përse universi ekziston dhe jo thjesht asgjë? Nga erdhi? Duhet të ketë patur ndonjë shkak që e solli universin në ekzistencë.

Ne mund ta përmbledhim argumentin tonë të deritanishëm si vijon:

1. Çfarëdo që fillon së ekzistuari ka një shkak.
2. Universi filloi së ekzistuari.
3. Rrjedhimisht, universi ka një shkak.

Nga vetë natyra e çështjes, si shkak i hapësirës dhe kohës, ky shkak duhet të jetë një qenie e pashkaktuar, e pandryshueshme, e pakohë dhe jolëndore me fuqi të paimagjinueshme, dhe i cili krijoi universin. Për më tepër, do të argumentoja unë, duhet të jetë i përveçëm gjithashtu. Sepse, përndryshe si ka mundësi që një shkak *i pakohë* t'i japë jetë një pasoje të *përkohshme* siç është universi? Nëse shkak do të ishte një kompleks i përgjithshëm kushtesh të domosdoshme dhe të mjaftueshme, atëherë shkak nuk mund të ekzistojë kurrë pa pasojën. Nëse shkak do të ishte i pranishëm përjetësisht, atëherë pasoja do të ishte gjithashtu e pranishme përjetësisht. Mënyra e vetme që shkak të jetë i përjetshëm dhe pasoja të fillojë në kohë është që shkak të jetë një faktor i përveçëm i cili zgjedh lirisht të krijojë një pasojë në kohë pa kushte vendimtare paraprake. Rrjedhimisht ne dalim, jo thjesht në një shkak transhendent të universit, por në Krijuesin e tij të Përveçëm. A nuk është e pabesueshme që teoria e Bing Bangut i shkon për shtat pra asaj që ka besuar ngahera teisti i krishterë: se në fillim Zoti krijoi universin? Tani, unë ju pyes: çfarë ka më shumë kuptim: fakti që teisti ka të drejtë apo fakti që universi erdhi befasi në ekzistencë prej hiçit pa asnjë shkak? Unë, të paktën, nuk kam asnjë problem të vlerësoj këto alternativa!

## Argumenti i dytë

2. *Rendi kompleks i universit.* Gjatë 30 viteve të fundit, shkencëtarët kanë zbuluar se ekzistenca e jetës inteligjente varet mbi një ekuilibër kompleks dhe të brishtë të kushteve fillestare që merren parasysh të vetë Big Bangut. Ne tani e dimë se universet jetë-*pengues* janë gjerësisht më të mundshëm sesa cilido univers jetë-*lejues* si ky i yni. Sa më i mundshëm?

Përgjigja është se mundësitë që universi të jetë jetë-*lejues* janë kaq pambarimisht të vogla saqë janë të pakuptueshme dhe të papërlllogaritshme. Për shembull, Stephen Hawking ka vlerësuar se nëse masa e zgjerimit të universit një sekondë pas Big Bangut do të kishte qenë më e vogël edhe sikur një faksion i njëqind milion të milionit, universi do të ishte rikthyer në një lëmsh të zjarrtë të ngohtë.[5] P. C. W. Davies ka përlllogaritur se gjasat kundër faktit se kushtet fillestare janë të përshtatshme për formimin e yllit të mëvonshëm (pa të cilin planetet nuk mund të ekzistojnë) është që pasohet, të paktën, nga miliarda miliarda zero.[6] John Barrow dhe Frank Tipler vlerësojnë se një ndryshim në fuqinë e gravitetit apo në atë të forcës së dobët me vetëm një fraksion të shkallës  $10^{100}$  do të kishte parandaluar një univers jetë-*lejues*. [7] Në rastin e Big Bangut janë të pranishme rreth 50 sasi dhe konstante të tilla të cilat duhen rregulluar imtësisht në atë mënyrë që universi të lejojë jetën. Dhe nuk është vetëm *secila* cilësi që duhet rregulluar kaq imtësisht; *përpyesimet* e tyre ndaj njëri tjetrit duhet të rregullohen gjithashtu imtësisht. Pra, pamundësia shumëfishohet nga pamundësia e pamundësisë

derisa mendjet tona gjenden në numra të pakuptueshëm.

Nuk ka asnjë arsye fizike përse këto konstante dhe sasi duhet të kenë vlerat që kanë. Fizikanti dikur agnostik Paul Davies komenton, 'Përgjatë punës sime shkencore unë kam filluar të besojë gjithnjë e më tepër fuqimisht se universi fizik është kompozuar me kaq zgjuarsa saqë unë nuk mund ta pranojë atë thjesht si fakt bruto.'<sup>[8]</sup> Në mënyrë të ngjashme, Fred Hoyle vëren, "Një interpretim me bonsens i fakteve sugjeron se një superintelekt ka luajtur me fizikën."<sup>[9]</sup> Robert Jastrow, kreu i Institutit Goddard të NASA-s për Studime Hapësinore, e quan këtë evidencën më të fuqishme që ka dalë ndonjëherë nga shkenca për ekzistencën e Zotit.<sup>[10]</sup>

Pra edhe një herë, pikëpamja që kanë mbrojtur ngahera teistët e krishterë, se ka një Projektues të universit, duket se është më afërmendsh sesa pikëpamje ateiste se universi, kur brofi në ekzistencë i pashkaktuar nga asgjë, thjesht ndodhi rastësisht që u rregullua imtësisht në një saktësi të pakuptueshme për ekzistencën e jetës inteligjente.

Ne mund të përmbledhim arsyetimin tonë siç vijon:

1. Rregullimi i imtësishtëm i kushteve fillestare të universit ka ndodhur për shkak, ose të ligjësisë, ose të rastësisë ose të projektimit.
2. Nuk ka ndodhur për shkak të ligjësisë apo të rastësisë.
3. Rrjedhimisht, ka ndodhur për shkak të projektimit.

### Argumenti i tretë

3. *Vlerat morale objektive në botë.* Nëse Zoti nuk ekziston, atëherë as vlerat morale objektive nuk ekzistojnë. Shumë teistë dhe ateistë pajtohen në këtë pikë. Michael Ruse, një filozof shkence i shquar dhe agnostik, shpjegon,

Pozicioni i evolucionistit modern është se ... morali është një përshtatje biologjike ashtu siç janë duart, këmbët dhe dhëmbët. E konsideruar si një kompleks logjikisht i justifikueshëm pretendimesh rreth një diçkaje objektive, etika është iluzion. Unë vlerësoj se kur dikush thotë, "Duaje fqinjin tënd siç do veten", ata mendojnë se mbi të gjitha po i referohen vetes. Megjithëkëtë, një referencë e tillë është përnjimend pa themele. Morali është thjesht një ndihmës për mbijetesën dhe riprodhimin. . . dhe çdo kuptim më i thellë është iluzion.<sup>[11]</sup>

Friedrich Nietzsche, ateisti i madh i shekullit të kaluar i cili shpalli vdekjen e Zotit, e kuptoi se vdekja e Zotit nënkuptonte shkatërrimin e të gjithë kuptimit dhe vlerës së jetës.

Unë mendoj se Friedrich Nietzsche kishte të drejtë.

Por ne duhet të tregojmë shumë kujdes këtu. Pyetja këtu *nuk* është: "A duhet të besojmë në Zot në mënyrë që të kemi jetë të moralshme?" Unë nuk po them që ne duhet. Dhe nuk bëhet fjalë as për pyetjen: "A mund të njohim vlerat morale objektive pa besuar në Zot?" Unë mendoj se ne mundemi.

Më saktë, pyetja është: "Nëse Zoti nuk ekziston, a ekzistojnë vlerat morale objektive?" Ashtu si prof. Ruse, unë nuk gjej asnjë arsye për të menduar se në mungesë të Zotit, morali i evoluar nga *homo sapiens-i* është objektiv. Dhe mendoj se këtu Dr. Pigliucci do të pajtohej me mua. Ai shkruan, "Ka qenë

mëse e qartë që nga Darvini se ne, përnjimend, nuk jemi asgjë pos makina.' [12] Në mungesë të Zotit, ne jemi thjesht nënprodukte të rastësishme të natyrës të cilët janë evoluar relativisht së fundmi mbi një grimcë pambarimisht të vogël dhe të humbur diku në një univers armiqësor dhe të pamend dhe të cilët janë të dënuar të shuhen individualisht dhe kolektivisht në një kohë realitativisht të shkurtër. Në këndvështrimin ateist, disa veprime, le të themi, përdhunimi, mund të mos jenë të dobishme nga ana sociale dhe kështu në vazhden e zhvillimit njerëzor ai është bërë tabu; por kjo nuk vërteton absolutisht aspak se përdhunimi është vërtet i gabuar. Në këndvështrimin ateist, nuk ka asgjë të gabuar nëse ti *përdhunon* dikë. Rrjedhimisht, pa Zotin nuk ka asnjë të drejtë dhe gabim absolut që imponohet vetvetiu mbi ndërgjejen tonë.

Por problemi është se vlerat morale *vërtet* ekzistojnë, dhe thellë brenda nesh të gjithë e dimë këtë. Nuk ka asnjë arsye tjetër për të mohuar realitetin objektiv të vlerave morale sesa realiteti objektiv i botës fizike. Veprime si përdhunimi, mizoria, dhe abuzimi me fëmijët nuk janë sjellje të papranueshme nga ana sociale – ato janë neveri morale. Disa gjëra janë vërtet të gabuara. Në mënyrë të ngjashme, dashuria, barazia dhe vetësakrificimi janë vërtet të mira.

Rrjedhimisht, ne mund ta përmbledhim këtë konsideratë të tretë si vijon:

1. Nëse Zoti nuk ekziston, vlerat morale objektive nuk ekzistojnë.
2. Vlera objektive ekzistojnë.
3. Rrjedhimisht, Zoti ekziston.

#### **Argumenti i katërt**

4. *Faktet historike që i përkasin jetës, vdekjes dhe ringjalljes së Jezuit.* Personi historik Jezui i Nazaretit ka qenë një individ i mrekullueshëm. Kritikët e Dhjatës së Re kanë arritur në një farë konsensusi se Jezui historik hyri në skenë me një sens të paprecedentë të autoritetit hyjnor, me autoritetin për t'u ngritur dhe për të folur në vend të *Zotit*. Ai deklaroi se Mbretëria e Zotit kishte ardhur tek ai, dhe si manifestime të dukshme të këtij fakti ai kreu një shërbesë me mrekullira dhe çyshtje. Por konfirmimi suprem i deklaramit të tij ishte ringjallja nga të vdekurit. Nëse Jezui u ngjall nga të vdekurit, atëherë do të dukej se ne kemi në duar një mrekulli hyjnore dhe se rrjedhimisht, kemi evidencë për ekzistencën e Zotit.

Tani, pjesa më e madhe e njerëzve me shumë gjasa do të mendonin se ringjallja e Jezuit është diçka që thjesht pranohet në besim ose jo. Por faktikisht ka tre fakte të rrënjësura thellë, të njohura nga shumica e historianëve të Dhjatës së Re sot, të cilat unë besoj se shpjegohen më së miri me anë të ringjalljes së Jezuit.

Fakti #1: *Të dielën pas kryqëzimit të tij, varri i Jezuit u gjet bosh nga një grup prej ndjekësve të tij femra.* Sipas Jacob Kremer, studiues austriak ky që është specializuar në studimin e ringjalljes, "Deri më tani, pjesa më e madhe e studiuesve pohojnë me forcë besueshmërinë e deklaramëve biblike rreth varrit bosh." [13] Sipas D. H. Van Daalen, është jashtëzakonisht e vështirë të kundërshtohet varri bosh mbi baza *historike*; ata që e mohojnë e bëjnë këtë mbi baza të hamendësimeve teologjike ose filozofike. [14]

Fakti #2: *Në raste të ndara, individë dhe grupe të ndryshme kanë parë imazhe të Jezuit të gjallë pas vdekjes së tij.*

Sipas kritikut të shquar të Dhjatës së Re, Gerd Lüdemann nga universiteti Vanderbilt, “Mund të merret si historikisht e sigurtë se. . . pas vdekjes së Jezuit, dishepujt patën eksperiencë në të cilat Jezui iu shfaq atyre si Krishti i Ringjallur.<sup>15</sup> Këto shfaqje u dëshmuuan jo vetëm nga besimtarë, por gjithashtu nga jobesimtarë, skeptikë dhe madje dhe armiqë.

Fakti #3: Dishepujt fillestarë befaz zunë të besonin në ringjalljen e Jezuit pavarësisht se kishin prirjen për të kundërtën. Çifutët nuk kishin asnjë besim në një Mesi të vdekur, e aq më pak të ringjallur, dhe besimet çifute rreth jetës së përtejme pengonin ringjalljen e kujtdo nga të vdekurit para fundit të botës. Megjithatë, dishepujt fillestarë zunë të besonin kaq fuqimisht që Zoti kishte ringjallur Jezuin sa që ishin të gatshëm të vdisnin për të vërtetën e këtij besimi. Luke Johnson, një studiues i Dhjatës së Re nga Universiteti Emory, mediton, “Nevojitet një farë përvoje e fuqishme, transformuese për të gjeneruar atë tip lëvizjeje siç ka qenë krishterimi më i hershëm. . . .”<sup>16</sup> N. T. Wright, një studiues i shquar britanik, del në përfundimin, “Andaj, si historian, unë nuk mund të shpjegoj ngritjen e krishterimit të hershëm vetëm nëse Jezui u ringjall sërish, duke lënë një varr bosh pas tij.”<sup>17</sup>

Përpjekjet për flakur tutje këto tre fakte të mëdha – si psh. dishepujt grabitën trupin apo Jezui nuk ishte vërtet i vdekur — janë hedhur poshtë universalisht nga studimet bashkëkohore. Është fakt i thjeshtë se nuk ka asnjë shpjegim natyror bindës për këto fakte. Rrjedhimisht, kështu më duket mua, i krishteri është mëse i përligjur të besojë se Jezui u kthye nga të vdekurit dhe ishte ai që pretendoi të ishte. Por kjo nënkupton se Zoti ekziston.

## Argumenti i pestë

5. *Përvoja e drejtëpërdrejtë e Zotit.* Ky në të vërtetë nuk është një argument për ekzistencën e Zotit; më saktë është deklarimi se mund të njohësh që Zoti ekziston krejtësisht ndaraz nga argumentet thjesht me anë të të përjetuarit të drejtëpërdrejtë të Tij. Nëse sinqerisht je në kërkim të Zotit, Ai do ta bëjë ty të qartë ekzistencën e tij. Bibla premt, “Afroju pranë Zotit dhe Ai do të afrohet pranë teje.”<sup>18</sup> Ne s’duhet pra të përqëndrohemi mbi provat se ne nuk arrijmë të dëgjojmë zërin e brendshëm të Zotit në zemrën tonë. Për ata që dëgjojnë, Zoti bëhet një realitet i drejtëpërdrejtë në jetën e tyre.

Në përfundim, pra, s’na mbetet veçse të shohim argumente që tregojnë se Zoti *nuk* ekziston, dhe ne *kemi* parë pesë arsye për të menduar se Zoti ekziston. Së basku, këto arsye përbëjnë një çështje të fuqishme për ekzistencën e Zotit.

## Fjalimi hyrës i Dr. Pigliucci’s

Faleminderit. Pikë së pari më lejoni të falenderoj disa njerëz: Komisionin e Botimeve për ftesën që më bëri për të kryer këtë detyrë të lakmueshme si dhe Racionalistët e Tenesisë Lindore që gjenden në sallë dhe atje në një nga tryezat, duke më dhënë një mbështetje të madhe, dhe, sigurisht, dr. Craig, i cili ka dhënë argumente mjaft të vlefshme nga ana e tij, dhe të gjithëve ju për faktin që keni ardhur. Unë e kuptoj se pozicioni që do të shpjegoj në ato pak minuta të ardhshme është një pozicion pakice. Shpresoj që deklaratimet e mia sonte do t’ju ndihmojnë sadopak në udhëtimin tuaj personal intelektual, ashtu siç më kanë ndihmuar mua në të kaluarën. Lejomëni të filloj me një farë mohimi. Ky është një mohim nga një filozof i quajtur Baruch Spinoza; ai ka thënë: ‘Unë kam bërë përpjekje të pareshtura për të mos përqeshur, për të mos përbuzur veprimet njerëzore, por për t’i kuptuar ato.’ Ky është qëndrimi im sonte. Unë nuk jam këtu për të vënë ndokënd në lojë. Unë nuk jam këtu për të përqeshur ndokënd. Unë gjendem këtu thjesht për të shpallur atë që unë mendoj se është një qëndrim konsistent dhe



jashtëzakonisht iluminues. Unë gjithashtu do të dëshiroja të bëja të qartë se qëndrimet e mia janë, ç'është e vërteta, të përkohshme. Unë nuk jam i lidhur përjetësisht me një besim të veçantë. Unë do të martohem pas disa muajsh me një grua të mrekullueshme, por kjo është një çështje tjetër.

## **Qartësim i termit 'Zot'**

E pra, lejomëni t'ia nis duke qartësuar se çfarë është saktësisht ajo gjë për të cilën po flasim sonte si dhe cili është qëndrimi im, dhe rrjedhimisht ne do të na duhet të flasim për shtigjet e shkencës dhe kufizimet e saj. Në lidhje me kufizimet e shkencës: shkenca nuk mund të hulumtojë deklaratimet negative, dhe deklaratimet negative nuk mund të vërtetohen, pavarësisht se ç'mund të thotë një njeri. S'ka asnjë mënyrë për të vërtetuar mosekzistencën e diçkaje, vetëm nëse më parë ju nuk përkufizoni këtë diçka nëpërmjet deklaratimeve pozitive. Kështu, për shembull, ju nuk mund të më kërkoni mua të sjell një provë për mosekzistencën e Zotit pa qartësuar se çfarë nënkuptoni me Zot – është krejtësisht e pamundur. Prandaj unë nuk jam duke mbështetur një qëndrim ateist – qëndrimin ekstrem ateist, nëse dëshironi. Nëse lexoni programin, unë përkufizohem si natyralist jo-teist, gjë e cila shpresoj se do të bëhet e qartë brenda një minute se çfarë nënkupton.

Pra, për ç'lloj Zoti mund të flasim? Pikë së pari, ka tre tipe Zotash që mua më vijnë ndër mend. Ka një tip metafizik Zoti. Ky është tipi i Zotit që nuk ka asnjë tipar, që nuk ndërhyjnë në jetën e përditshme të botës. Ai mund të ketë krijuar botën, por, paskëta ai u tërhoq. Ky tip Zoti është krejtësisht i papërgjeshtrueshëm; shkenca nuk ka të bëjë aspak me atë, dhe racionalizmi gjithashtu nuk ka të bëjë më të. Nuk ka asnjë mënyrë për të mohuar këtë tip Zoti. Unë jam mëse i sigurtë se faktikisht jo shumë njerëz të pranishëm këtu besojnë në këtë tip Zoti sepse nuk është mjaftueshëm i plotë. Nuk na vyen për asgjë

Një tip i dytë Zoti quhet Zoti antropomorfik i papërkryer. Ai është një Zot që ka tipare njerëzore, apo tipare të ngjashme me njeriun, por është i papërkryer; ai bën gabime. Grekët e lashtë qenë të parët që përshkruan këtë tip Zoti, dhe madje ata nuk besuan aq shumë në lidhje me këtë lloj qenie, thjeshte sepse nëse ai është i gabueshëm, atëherë ai nuk është më i mirë se një qenie njerëzore. Mund ta mendoni atë si një qenie mjaft të fuqishme njerëzore, por ai mbetet person. Pra, ne do ta lëmë mënjatë edhe këtë tip Zoti.

Ai për të cilin ne po flasim sonte është ai që ne e quajmë Zoti i përkryer antropomorfik, që do të thotë, një Zot që ka të bëjë deri diku me punën e përditshme të universit, por ai është i përkryer, nuk bën gabime, është gjithmonë i mirë, është kudo. Ky është tipi i Zotit që unë mendoj se faktikisht mund të përgjeshetrohet deri në njëfarë mase. Me fjalë të tjera, nëse ju besoni në atë tip Zoti, ju po bëni deklaratime pozitive për atë që duhet të ndodhë në univers; dhe nëse ju bëni deklaratime pozitive rreth asaj që mund të ndodhë në univers, atëherë shkenca dhe mendimi racional mund të kenë diçka për të thënë rreth kësaj.

## **Argumenti nga Projektimi**

Le t'ia fillojmë me argumentin e projektimit inteligjent, të cilin dr. Craig e paraqiti në fillim të fjalës së tij. Argumenti nga projektimi inteligjent thotë se universi është kaq kompleks saqë duhet të ketë patur medoemos një projektues; pra, nëse gjeni një orë diku, ju e dini se ka një orëpunues. Kur nga ana e saj, shkenca ju thotë, jo, kjo mund të jetë e vërtetë për orën, por të shohësh një projektues nuk do të thotë se ka një projektues të ndërgjegjshëm e inteligjent. Vini re se këtu unë po pranoj që bota është 'projektuar'. Përzgjedhja natyrore, për shembull, në rastin e evolucionit biologjik është pa dyshim një

projektues. Por është projektues i pandërgjegjshëm, një projektues që punon mekanikisht. Nuk punon duke ndjekur një qëllim më të lartë. Pra, ne biem dakord se ka një projektues. Pyetja është kush është projektuesi apo çfarë është projektuesi.

Një nga argumentet më të mira të Darvinit kundër qëndrimit teist ishte ai se nëse vështroni vërtet nga afër universin – madje nuk keni as përse ta vështroni nga aq afër — do të zbuloni se nuk është aspak i përsosur, dhe rrjedhimisht mund të shtroni pyetjen se deri në ç’masë pasqyron në të vërtetë një projektues. Për shembull, e ashtuquajtura përsosmëri e qënieve njerëzore është vënë në pikëpyetje: ju mbase e dini se qëniet njerëzore kanë një strukturë të çuditshme në syrin e tyre. Syri dikur ka qenë një shembull i preferuar nga teistët. Është një lloj strukture që nuk mund të shpjegohet përveçse nëpërmjet projektimit. Por, është i projektuar si mos më keq, sepse, për shembull, ne kemi enë gjaku pikërisht mu para retinës, gjë që do të thotë se në rrethana të caktuara drite disa nga ne shohin këto gjëra të vogla zbavitëse që fluturojnë në të gjithë fushën pamore. E pra, ky nuk është një projektim i mirë. Jo vetëm kaq, por ka organizma që janë projektuar më mirë. Kallamarët, për shembull, i kanë enët enët e gjakut në pjesën e pasme të syrit, pra ata faktikisht shohin shumë më mirë se ne, ndonëse pavarësisht nga gjithçka këta dy tipe syri janë shumë të ngjashëm. Pra pyetja ime për ju është: a jemi ne të projektuar më mirë sepse Zoti pëlqeu më shumë kallamarët sesa qëniet njerëzore? Ky më duket se është mesazhi.

Një tjetër burim i projektimit të keq është fakti se pjesa më e madhe e reaksioneve kimike që ndodhin brenda trupit të cilitdo – njerëzve, kafshëve dhe bimëve – janë faktikisht mjaft të paefektshme, dhe po t’i lypni një fizikanti apo një kimisti disa përlllogaritje, është mjaft e thjeshtë, dhe ata do t’ju tregojnë se metabolizmi i pjesës më të madhe të bimëve dhe kafshëve, përfshirë njerëzit, është përnjimend i projektuar keq. Nuk funksionon shumë mirë, i çon dëm lëndët, prodhon shumë produkte të pavlera. Pra, nëse ka një projektues, ai nuk është një projektues i mirë.

Më tutje, ekzistojnë pyetje që një tesit, i cili beson në projektimin e përkryer, e ka vërtet të vështirë t’i shpjegojë. A e keni pyetur ndonjëherë veten përse njerëzit kanë hemorroide? Arsyeja për këtë është se ne jemi të prirur të ecim në këmbë, por ne nuk jemi të projektuar mirë për këtë, dhe ne e kemi paguar këtë me disa pasoja, përfshirë hemorridet dhe zgjerimin e venave. Pra kjo duhet të shpjegohet në logjikën se nëse ka patur një projektues, ai s’ka qenë i mirë.

Argumenti i përgjithshëm që shtrojnë disa shkencëtarë të paktën, dhe unë bie dakord me ata, është se sa më tepër njohuri të përftojme rreth natyrës, aq më tepër kuptojmë se faktikisht bota është pasojë e dy gjërave: rastësisë, e cila shpeshherë quhet pasiguri historike, si dhe domosdoshmërisë, e cila zakonisht lidhet me përzgjedhjen natyrore. Rrjedhimisht qëndrimi im nuk është se ne jemi rezultat i rastësisë, sepse rastësia e vetme, dhe dr. Craigu ka të drejtë këtu, nuk mund të krijojë kurrësesi një strukturë kaq komplekse si ekosistemi. Por rastësia dhe përzgjedhja natyrore së bashku janë tjetër gjë. Përzgjedhja natyrore mund të funksionojë me mjaft frytshmëri me kalimin e periudhave më të gjata kohore.

## **Zoti dhe Natyra**

Më tutje, mua më duket se sa më tepër të mësojmë rreth mekanizmave të botës, pra, sa më tepër të kuptojmë botën, aq më tepër zbrapset mbretëria e Zotit. Arsyeja është, nëse mendoni rreth saj, në kohërat lashta njerëzit e kishin zakon t’i referoheshin Zotit si shpjegim për pothuajse gjithçka. Kishte një shkrepëtimë a bubullimë – epo, ky ishte Zeusi që qe merzitur me dikë. Tani ne dimë më shumë, dhe nuk quajmë Zotin përgjegjës për këto gjëra. Tani ne mund ta izolojmë dhe kufizojmë atë vetëm te



ato gjëra që ne nuk i kuptojmë, pyetjet madhore që ne ende i bëjmë në shkencë, si origjina e universit apo fillesa e jetës. Për përveç këtyre, ne e kuptojmë gjithnjë e më mirë se si funksionojnë gjërat. Fundja fundit, shkenca është rreth nesh prej vetëm dyqind vjetësh. Na jepni ca kohë! Sa më tepër të kuptojmë, aq më pak vend duke se ka për ekzistencën e Zotit. Tani, nëse e zgjerojmë sadopak kuptimin, ju do të kuptoni se nuk keni asnjë arsye rreth Zotit.

Faktikisht, ky argument u paraqit më shumë se një shekull më parë nga astronomi Laplas, i cili ishte i pari që paraqiti një teori të plotë për fillësën dhe zhvillimin e sistemit diellor, teori kjo, meqë ra fjala, që vazhdon të konsiderohet mjaft korrekte. Ai e paraqiti teorinë e tij para Akademisë Kombëtare Franceze, dhe Napoleoni ishte i pranishëm aty. Në fund të prezantimit, Napoleoni e pyeti Laplasin, 'Mësjë Laplas, po Zoti?' Dhe Laplasi e pa në sy Napoleonin, dhe tha, 'Nuk më duhet më ajo hipotezë.' Dhe këtu gjendet çelësi. Zoti është një hipotezë e formuluar prej nesh, e krijuar prej nesh, kur nuk kuptojmë se ç'ndodh në të vërtetë.

### Argumenti nga Rregullimi i Imtësishëm

Tani, duke iu kthyer çështjes, kufiri aktual i argumentit të projektimit është, ashtu siç e ceku dr. Craigu, ideja se universi fizik është tej mase i pamundur. Universi fizik aktual, ai që mbështet jetën siç e njohim ne, është tej mase i pamundur. Unë nuk do të hyj në detajet e argumentit të dr. Craig ndoshta gjatë kundërshtimit tim, sepse unë dëshiroj të shtroj disa pika të tjera; por disa prej pikave kryesore që linden në mendje në përgjigje ndaj atij lloj argumenti, janë: pikë së pari, fakti që ne s'e dimë se si funksionon diçka, siç nuk dimë se si lindën konstantet fizike, nuk është kurrësesi një evidencë pozitive për ekzistencën e Zotit. Këtu ka një *non sequitur*, ka një hendek në logjikë. Fakti se ne pranojmë që ka disa gjëra të cilat ne nuk i kuptojmë, nuk nënkupton aspak se ka patur një krijues. Thjesht do të thotë që ne nuk e dimë, dhe ky është qëndrimi që çdo shkencëtar i vërtetë duhet të mbajë.

Më tutje, sa i mundshëm është universi? Epo, ne nuk e dimë sepse ky është i vetmi univers që ne kemi. Ne mund të spekulojmë, është shumë e vështirë të nxjerrim numra – faktikisht, është shumë e lehtë të nxjerrim numra, por është e vështirë të nxjerrim numra të arsyeshëm. Ne nuk kemi eksperimente; ne nuk mund të eksperimentojmë kaq lehtë me lloje të ndryshme universesh. Kështu, për shembull, unë bëra disa përllogaritje: po supozoj se ka pak më shumë se një mijë njerëz këtu sonte, dhe unë kam bërë disa përllogaritje se cili është probabiliteti që çdonjëri prej këtyre personave do të gjendej këtu sonte. Meqënëse tani mbi tokë ka 5 miliardë njerëz, probabiliteti është 1 në 10 i rritur në 1000 i rritur në 5 miliardë. Kjo është një shifër që të kall datën. Pra, nëpërmjet këtij arsytimi ose dikush vërtet ka komplotuar që nga fillesa e jetës sonë për të na sjellë këtu sonte ose kjo ngjarje është kaq e pamundur saqë, më vjen keq, ju keni iluzionin që ne jemi këtu, por ne nuk jemi këtu. A e kuptoni se deri ku mund të shkoj me këtë?

### Problemet me Teizmin

Në tërësi, ajo çka po diskutojmë sonte këtu është dallimi ndërmjet teizmit dhe naturalizmit, dhe unë mendoj se teisti ka një mori problemesh të cilat kanë nevojë për zgjidhje. Një nga këto probleme është se teizmi bën një supozim të pabazuar dhe që është i vështirë për t'u mbrojtur: supozon se përtej lëndës dhe energjisë ekziston diçka tjetër. Ky mund të jetë një supozim i arsyeshëm për disa njerëz prej publikut, në fakt jam i sigurtë se është kështu për shumicën e njerëzve prej publikut, por mendoni rreth saj. Ju e dini se lënda dhe energjia ekzistojnë. Ju nuk e dini se përtej kësaj ekziston diçka tjetër, dhe rrjedhimisht barra e provës nuk bie mbi mua që të tregojë se ajo diçka nuk ekziston; i takon dr. Craigut të tregojë se diçka tjetër ekziston, sepse ne të gjithë e dimë se lënda dhe energjia janë këtu.

Nëse ju keni nevojë për diçka tjetër, atëherë në na duhen disa prova.

Gjithashtu, duke iu përgjigjur cilëso pyetje rreth zanafillës së universit, zanafillës së jetës, apo gjithçkaje tjetër, 'Zoti e bëri atë' nuk është një përgjigje. Kjo nuk jep asnjë farë përgjigjeje; kjo nuk ka asnjë fuqi shpjeguese. Epo, si e bëri Zoti atë, si funksionoi ajo, përse funksionon kështu e jo në mënyrë tjetër? Shkenca nuk është thjesht për të dhënë një përgjigje. Unë nuk kam për t'ju thënë juve se njerëzit evoluojnë, pikë. Unë do t'ju them se si, në ç'kohëra dhe në ç'sekuencë ngjarjesh është i përfshirë faktikisht. Ka një shpjegim shumë më të detajuar; në fakt, ka një shpjegim. Mund të mos jetë një shpjegim i përkryer, por është një shpjegim ama.

Një tjetër problem është ajo që unë e quaj problemi i regresionit të pafundësishëm. Le të supozojmë madje se ne vërtet kemi nevojë për një Zot apo për një lloj entiteti mbinatyror që shpjegon universin; atëherë, pyetja e qartë që vijon është: nga vjen Zoti? Nuk kam arritur kurrë të gjej një përgjigje ndaj kësaj. Dhe nëse përgjigja është se ai ka qenë gjithnjë aty, kjo është pikërisht njësoj si të thuash se lënda dhe energjia kanë qenë gjithnjë aty. Nuk ka asnjë ndryshim.

Më tutje, ne kemi folur tashmë rreth problemit të evidencës negative. Ka një tendencë nga pala teiste për t'u kapur pas gjithçkaje që shkenca nuk mund t'i japë zgjidhje ose nuk mund të shpjegojë, të paktën për momentin, si një evidencë pozitive për shpjegimin e një alternative. Kjo nuk është mënyra se si funksionojnë gjërat në mendimin racional dhe në mendimin logjik. Ju duhet të keni argumentet tuaja, argumente pozitive, për të dhënë një shpjegim. Ju nuk mund të përzgjidhni gjithsa pala tjetër e ka të pamundur të shpjegojë, sidomos meqënëse pjesë e procesit të palës tjetër është pikërisht nxjerrja e shpjegimeve një nga një, dhe disa prej këtyre shpjegimeve mund të bien sepse ato nuk janë të mira.

## **E Vërteta e Natyralizmit**

Më tutje, unë do të doja të thoja se ka arsye shumë të mira për t'i besuar natyralizmit. Kjo është ana pozitive e argumentit tim. Së pari, natyralizmi ka fuqi parashikuese. Ka një mori gjërash që funksionojnë. Për shembull, ju mund të ndizni dritat, dhe vërtet ka ndriçim. Arsyeja për këtë është se elektronët lëvizin dhe këmbëjnë energji. Gjithë këto gjëra fizika i ka shpjeguar më së miri, pra funksionon. A mund të sillni një shembull të ngjashëm të fuqisë parashikuese në anën tjetër? Unë nuk mendoj kështu.

Më tutje, funksionon në praktikë. Arsyeja se përse ju djema ishit në gjendje të merrnit një makinë, për shembull, të vinit këtu sonte, është sepse teknologjia funksionon. Dhe teknologjia bazohet mbi natyralizmin. Nëse supozimet e natyralizmit nuk do të ishin konsekuente, ju nuk do të kishit makinë, nuk do të kishit televizor, nuk do të kishit një video regjistruar, dhe të gjitha këto pajisje të jetës. Tani, ju mund të argumentoni se ne duhet të jetojmë më mirë pa ato, por kjo është një çështje tjetër.

## **Problemi i të Ligës**

Qëndrimi teist ka gjithashtu disa probleme të rënda filozofike që unë e kam të vështirë të mendoj se si mund t'i japë zgjidhje dr. Craigu. Problemi kryesor që unë shoh është problemi i të ligës. Filozofi Bertrand Russell e ka thënë shumë bukur, dhe unë vështirë se mund ta them më mirë se ai, kështu që do të lexoj pothuajse fjalë për fjalë citimin e tij. 'Nëse unë kam patur dhjetë miliardë vjet dhe kjo është gjithsa unë mund të prodhoja, universin ashtu siç është, mua duhet të më vijë turp nga vetja'. Gjithsekush në këtë dhomë mund të mendojë për një univers më të mire, së paku pa tërmete dhe pa

stuhi dëbore, pa vrasje, pa përdhunime, e kështu me radhë. Është shumë e lehtë të prodhohet një univers i tillë. Pra, nëse ky Zot supozohet të jetë i gjithëfuqishëm dhe i mirë, atëherë përse këtu poshtë kemi këtë rrëmujë që kemi? Dhe ju lutem mos iu përgjigjini kësaj pyetje me “Djali e bëri këtë!” sepse djalli ishte gjithashtu krijim i Zotit, dhe kështu faji i mbetet gjithësesi atij. Dhe unë nuk shoh një rrugëdalje prej kësaj, vetëm nëse ju dëshironi të argumentoni se krijimi ka pasoja të padëshiruara, se ka gjëra në botë që Zoti përnjimend nuk i dëshironte; por në këtë rast ne po tërhiqemi në kategorinë e Zotit të përveçëm me mangësi që askush këtu sipas të gjitha gjasave nuk i beson.

## **Problemet me krishterimin**

Ka gjithashtu disa probleme specifike rreth krishterimit. Ajo që unë kam thënë deri këtu jetësohet në rastin e çdo përkufizimi pozitiv të Zotit. Siç thashë, unë nuk jam këtu për të mohuar ekzistencën e secilit Zot të mundshëm. Ka disa Zota që janë thjesht përtej çdo lloj argumenti teorik apo shkencor. Por, sa për siguri, a mund të më jepni një arsye të mirë për të besuar Zotin e krishterë në veçanti, përkundër shumë Zotave të tjerë që janë parashtruar deri më tani? Këtu keni alternativa të bollshme: mund të bezoni në Zeus, mund të besoni në Baal, mund të besoni te Zoroastra – ka mjaftueshëm syresh. Epo, përse njërin e jo tjetrin? Unë vërtet nuk gjej ndonjë arsye të veçantë për këtë.

Gjithashtu, krishterimi bën disa deklaramë specifike rreth botës dhe rreth njerëzve. Nëse ju besoni, për shembull, literalisht në Bibël (gjë e cila unë po supozoj se nuk ndodh në rastin e dr. Craigut), nëse ju besoni vërtet në Bibël, sigurisht, ju hipni në një mal me probleme. Shkenca mund të përgjigjet se nuk ka patur një gjë të tillë si përmbytja e Noes dhe pa dyshim kurrësesi një ngjarje të tillë mbarëbotërore. Gjëra të tjera janë: dielli nuk u ndal askund në qiell sepse dielli nuk lëviz aspak. Është Toka ajo që rrotullohet përreth diellit, dhe kështu me radhë. Pra, në Bibël ka një mori deklaramesh specifike që thjesht nuk mund të merren literalisht. Por edhe nëse ju i merrni ato literalisht dhe ju nxirrni një lloj kuptimi të përgjithshëm, atëherë, duke folur në një kuptim të përgjithshëm, njeriu supozohet se ka rënë nga diku, me sa duket nga hiri. Por, biologjia evolucionare na rrëfen se faktikisht njeriu u zhvillua në mënyrë pozitive dhe është një nga krijesat më komplekse sot në botë. Është produkti përfundimtar i një procesi mjaft të gjatë evolucionari; unë vërtet i shoh këto dy gjëra në kundërshtim të drejtëpërdrejtë.

Dhe në fund, sa i përket krishterimit në veçanti, ka evidenca të bollshme arkeologjike, antropologjike dhe sociologjike se krishterimi është vetëm një nga mitologjitë e shumta që u evolua dhe u ndryshua përgjatë gjithë historisë njerëzore. Është pjesë e kulturës njerëzore; rrënjët e tij datojnë që nga traditat hebraike, që nga traditat babilonase në Mesopotami. Një mori prej miteve të krishterimit janë huazuar ngado, siç janë mitet e tjera që ne i shohim sot si fe. Fetë ngrihen, bien, ndryshojnë, varësisht nga sfondi kulturor dhe social i popullatave që i përvetësojnë ato, dhe përfundimisht ato vdesin, dhe mandej diçka tjetër do të ngrihet për t’ua zënë vendin atyre. Kjo është sekuenca historike që ka ndodhur vazhdimisht duke u përsëritur nga e para, dhe unë e kam të vështirë të kuptoj se si ndokush mund të hedhë vështrimin në këtë sekuencë dhe të thotë, ‘Epo, kjo sekuencë e veçantë këtu është një përjashtim. Kjo nuk është thjesht si një fe tjetër dosido. Është e ndryshme.’ Epo mirë pra, por mbi ç’baza?

## **Problemi i moralit**

Së fundi, problemi i moralit, për të cilin unë jam i bindur se ne do të kemi shumë për të thënë – ah, po, unë pajtohem me dr. Craigun kur ai citoi dr. Ruse, një filozof shkence ky. Nuk ekziston një gjë e tillë si morali objektiv. Këtë e ka qartësuar mirë e bukur. Morali në kulturat njerëzore ka evoluar dhe është ende në evoluim, dhe ajo që është morale për ty mund të mos jetë morale për atë tjetrin që e ke ngjitur

dhe sigurisht nuk është morale për atë tjetrin përtej oqeanit, qoftë përtej Atlantikut apo Paqësorit, e kështu me radhë. Dhe çfarë të bën të besosh se morali yt personal është ai i sakti dhe gjithëkush tjetër është në gabim? Shikoni, një mënyrë e mirë për ta qartësuar këtë është se nuk është e njëjta gjë sikur të thuhet se gjithçka bën; nuk është aspak e njëjta gjë. Ajo çka bën është gjithçka që funksionon; ka gjëra që funksionojnë. Morali duhet të funksionojë. Për shembull, një prej arsyeve më të mira që ne nuk dalim rreth e rrotull duke vlarë njëri tjetrin është sepse në këtë rast e gjithë shoqëria siç ne e njohim do të shembej dhe ne do të shndërroheshim në një tufë kafshësh të thjeshta e të veçuara. Dhe kafshë të tilla ka.

## **Kundërshtimi i Parë i Dr. Craig**

### **Pyetja e Dytë**

Dr. Pigliucci më paraqet mua rreth pesë argumente që ai mendon se do të përgënjeshtrojnë hipotezën që Zoti ekziston. Le të hedhim një vështrim te secili prej tyre dhe të shohim nëse ato janë argumente bindës.

### **Argumenti nga Papërsosmëria**

(1) Ai thotë se universi nuk është i përkryer. Për shembull, kallamarët kanë sy më të mirë se sa qëniet njerëzore. Unë mendoj se ky argument kurrësesi nuk hedh poshtë ekzistencën e Zotit. Lejomëni të përmend tre arsye.

Së pari, ky kundërshtim supozon një teori statike të krijimit – se Zoti krijoi çdo krijesë individuale, e cila nuk ndryshon kurrë. Por edhe kreacionistët kanë karakteristikë pohimin e një teorie dinamike të krijimit e cila lejon ndryshime mikro-evolucionare brenda llojeve të caktuara, ashtu që të mund të krijohet një lloj kryesor qenieje dhe mandej do të kishte ndryshim mikro-evolucionar brenda këtij lloji, dhe ju mund të hidhni një vështrim në këtë lloj papërsosmërie (siç e quan ai) si nënprodukte të trysnive mikro-evolucionare që shfaqen shkallë-shkallë.

Së dyti, kundërshtimi supozon që dihet se ç'do të bënte Zoti nëse Ai do të projektonte diçka, se ne e dimë që Zoti do të krijonte syrin në një mënyrë të caktuar nëse Ai do të ekzistonte, apo se Ai do të krijonte sistemin tretës në këtë mënyrë nëse Ai do të ekzistonte. Dhe unë personalisht mendoj se kjo është thjesht arrogancë. Ne nuk kemi asnjë ide si të spekullojë rreth asaj që Zoti do të krijonte nëse Ai do të ekzistonte. Ndoshta nuk është e rëndësishme për Zotin që ne të jemi në gjendje t'i kemi sytë për të parë pikërisht në një mënyrë të caktuar, ndoshta ka arsye të tjera përse Zoti i lejon të ekzistojnë sistemet e projektuar në këtë mënyrë. Me fjalë të tjera, argumenti është jashtëzakonisht arrogant po të mendohet se ne e dimë çfarë do të krijonte Zoti nëse ai do të ekzistonte.

Dhe së treti, përsosmëria, fundja fundit, është term relativ. Këto organe të supozuara të papërsosura, si syri i njeriut, funksionojnë jashtëzakonisht mirë. Dua të them, mendoni se çfarë ka bërë syri i njeriut kur flasim për artin, letërsinë, arkitekturën, e kështu me radhë! Kjo vështirë se mund të jetë evidencë bindëse, them unë, që ato të mos jenë produkt i një projektuesi inteligjent.

Faktikisht, kjo më shpie në argumentin tjetër, që i përket evolucionit biologjik. Dhe unë do të sugjeroja se ideja që evolucionit mund të ketë ngjarë pa një Projektues inteligjent është kaq e pamundur saqë mund të quhet fantazmagorike. Kjo është treguar nga Barrowand dhe Tipler në librin e tyre *The Anthropic Cosmological Principle*. Në këtë libër, ata rendisin dhjetë hapa në vazhden e evolucionit

njerëzor, ku çdonjëri prej të cilëve është kaq i pamundur saqë para se ndonjëri të mund të ketë ndodhur, dielli do të kishte reshtur së qeni një yll i rendit kryesor dhe do të kishte shkaktuar djegien e tokës.[19] Ata vlerësuan se gjasat e evolucionit të materialit gjenetik njerëzor janë të rendit  $4^{-360}$  (110,000), numër ky që është kaq i madh saqë ta quajë astronomik do të përbënte një nënvlerësim të tepruar. Me fjalë të tjera, nëse evolucioni vërtet ka ngjarë, do të duhej të kishte qenë mrekulli, kështu pra që evolucioni është faktikisht evidencë për ekzistencën e Zotit! Dhe këtu të krishterët mund të jenë shumë më të hapur se ku shpie evidenca. Ai mund të thotë, ‘epo mirë pra, Zoti mund të ketë përdorur evolucionin. Ai mund të ketë përdorur krijimin e veçantë. Unë jam I hapur për evidencat!’ Por, shikoni, evolucionin natyralist është e vetmja lojë që shfrytëzohet! Sado fantazmagorike të jenë gjasat, sado të pamundura të jenë evidencat, evolucionin i ka ngecur sahati sepse nuk ka një Projektues inteligjent. E kështu, mua më duket se i krishteri mund të jetë shumë më tepër objektiv në këtë pikë. Fundja fundit, nëse ju do të gjenit një orë në tokë, dhe, le të themi, ora nuk funksionon në mënyrë përkryer, ecën me një minutë më pak në orë, a do të dilni rrjedhimisht në konkluzionin se ora nuk është projektuar siç duhet?

### **Argumenti i Regresionit**

(2) Po në lidhje me argumentin e regresionit, atë se sa më shumë ne mësojmë aq më pak ne mendojmë se Zoti ndërhyr në univers? Vini re se argumenti nuk vërteton që Zoti nuk ekziston. Madje as nuk vërteton se Zoti nuk ndërhyr shpeshherë në univers. Gjithsa vijon nga ky argument është faktori sociologjik se ne nuk mendojmë që Zoti ndërhyr shpeshherë në univers. Dhe ky konkluzion është krejtësisht në përputhje me idenë se Zoti faktikisht ndërhyr vërtet shpeshherë në univers. Por, më tutje, edhe nëse do të ishte e vërtetë se Zoti nuk ndërhyr shpeshherë në univers me mënyra të mrekullueshme, kjo nuk është e papajtueshme me krishterimin. Fundja fundit, mrekullitë nga natyra janë të rralla, dhe unë nuk mendoj se Zoti del shpeshherë rreth e rrotull duke ndërhyrë në univers me mënyra të mrekullueshme. Pra argumenti është thjesht jobindës.

### **Argumenti Pragmatik për Natyralizmin**

(3) Po në lidhje me argumentin se natyralizmi funksionon? Kurrësesi! Ato që funksionojnë janë hipotezat shkencore. Por ato nuk e vënë në provë natyralizmin sepse kjo mund të funksionojë edhe mbi hipotezat se ka një Zot Krijues i cili e ka projektuar universin që të operojë sipas ligjeve të caktuara natyrore. Pra, fakti se teoritë shkencore funksionojnë nuk është në asnjë sens provë për natyralizmin.

### **Problemi i të Ligës**

(4) Ai thotë, “Po në lidhje me problemin e të ligës?” Më lejoni të japë dy përgjigje këtu.

E para, asnjë atesit nuk ka arritur asnjëherë të tregojë një mospërputhje logjike ndërmjet pohimeve ‘Zoti ekziston’ dhe ‘E Liga ekziston’. Ata janë përpjekur, por askush nuk ka qenë asnjëherë në gjendje të tregojë se këto të dyja janë kontradiktore. Ç’është e vërteta, ju mund të tregoni se ato janë të pajtueshme duke shtuar një pohim të tretë, gjegjësisht, ‘Zoti ka arsye të mjaftueshme morale për të lejuar të ligën’.

Për sa kohë që ky pohim i tretë është me gjasë i vërtetë, ai tregon se ekzistenca e Zotit dhe ekzistenca e të ligës janë logjikisht të pajtueshme. Ateisti duket se supozon që nëse Zoti ka arsye të mjaftueshme morale për të lejuar ligësinë, ne duhet të ndajmë të fshehtat me ata. Por nuk ka absolutisht asnjë arsye për të menduar se kjo është e vërtetë.

Faktikisht, së dyti, ligësia, ç'është e vërteta, është provë se Zoti ekziston. Argumenti im do të ishte i tillë:

1. Nëse Zoti nuk ekziston, vlerat objektive morale nuk ekzistojnë. (Dr. Pigliucci bie dakord.)
2. Ligësia ekziston.
3. Rrjedhimisht, vlerat objektive ekzistojnë. (Ka gjëra që janë vërtet të liga.)
4. Rrjedhimisht, Zoti ekziston.

Për pasojë, ligësia vë në pikëpyetje ekzistencën e Zotit vetëm në rrafsh sipërfaqësor. Në një rrafsh më të thellë filozofik, ajo, ç'është e vërteta, tregon ekzistencën e Zotit sepse ligësia në vetvete nuk mund të ekzistojë pa Zotin.

## Arka e Noes

(5) Argumenti i pestë që ai ngriti ishte problemi i arkës së Noes. Unë thjesht nuk do ta pranoja duke thënë: së pari, nuk përgënjeshton ekzistencën e Zotit. Së dyti, unë përmbytjen e Noes do ta trajtoja sidoqoftë si një përmbetje lokale, jo të përbotshme.

Pra të gjitha këto argumente, mendoj unë, janë ose të pavlefshme ose të bazuara në premisa të rreme dhe vështirë se paraqesin ndonjë arsye të mirë për të menduar se ateizmi është i vërtetë.

## Pyetja e parë

Dhe tani, po në lidhje me argumentet e mia që tregojnë se Zoti vërtet ekziston? Dr. Pigliucci përdor një argument të përgjithshëm kundër kësaj për të thënë se Zoti nuk është një shpjegues. Por vini re se ai nuk arrin të kuptojë strukturën e argumenteve të mia. Argumentet e mia janë argumente deduktive, që do të thotë, se nëse premiset janë të vërteta, atëherë nga ligjet e logjikës vijon një konkluzion i pashmangshëm. Qoftë nëse ju pëlqen konkluzioni, qoftë nëse ju mendoni se është shpjegues, kjo është e parëndësishme: për sa kohë që premiset janë të vërteta, nga logjika deduktive rrjedh se konkluzioni është i vërtetë.

## Argumenti i Parë

Pra, çfarë do të mohojë ai? Në argumentin tim të parë unë argumentova: (1) *Çfarëdo që fillon së ekzistuari ka një shkak*. A do ta mohojë ai këtë? (2) *Universi filloi së ekzistuari*. Sipas Steven Ha?king në librin e tij *The Nature of Space and Time*(1996), "Pothuajse gjithësekush tani beson se universi, dhe vetë koha, pati zanafillën e saj me Big Bangun."<sup>[20]</sup> A do ta mohojë ai këtë, paradigma e pohuar nga shumica e kozmologëve sot? Nëse ai nuk do të mohojë njërin nga këto dy premisa, atëherë ai nuk mund të mohojë konkluzionin, se *Ekziston një shkak transhendent i universit*.

Ai thotë, po mirë, po nga erdhi Zoti? Mund t'i përgjigjem mjaft lehtë kësaj pyetjeje. Ky argument



vërteton se nuk mund të ketë një regresion të pafundësishëm shkaqesh. Rrjedhimisht, duhet të ketë një shkak të parë i cili kurrë nuk ka ardhur në ekzistencë; por një qenie e cila ekziston pa kohë, pa hapësirë dhe domosdoshmërisht është e pashkak. Kjo është që ateisti ka thënë ngahera se është universi. Por kjo tani është e pambrojtshme nën dritën e argumenteve filozofike që unë dhashë dhe nën dritën e evidencës kozmologjike për zanafillën e universit.

Me fjalë të tjera, *asnjëra* nga dy premisat të argumentit tim të parë nuk u rrëzua nga dr. Pigliucci, dhe për pasojë, unë mendoj se ne kemi baza të forta për të menduar se një Krijues transhendent ekziston.

## Argumenti i Dytë

Argumenti im i dytë bazohej në rendin kompleks të universit. Dhe këtu ai pati tre kundërshtime.

(1) Nuk mund të kërkosh një Krijues nga ajo që nuk e dimë. Unë nuk po argumentoj mbi bazat e asaj që ne nuk e dimë. Unë po sygjeroj se ne *vërtet e dimë* që kushtet fillestare të universit nuk mund të shpjegohen nëpërmjet ligjit sepse ato janë kushte fillestare. Ato nuk mund të shpjegohen nëpërmjet rastësisë sepse kjo është thjesht jashtëzakonisht e pamundur. Dhe rrjedhimisht, duke mos qenë e shpjegueshme as nga rastësia e as nga ligji, projektimi është e vetmja alternativë. Cila është përgjigja e tij? Unë do të doja ta dija.

(2) Ai thotë, “argumenti juaj nuk funksionon sepse ka vetëm një univers.” Lejomëni të shpjegoj teorinë e probabilitetit ku mbështetet kjo. Imagjinoni një njollë blu mbi një copë letre, dhe le të jetë ky universi ynë. Ndryshoni paksa disa prej këtyre konstanteve dhe sasive. Kjo bën një univers të ri. Nëse është jetë-lejues, bëni një tjetër njollë blu. Nëse është jetë-ndalues, bëni një njollë të kuqe. Mandej bëjeni këtë sërish, dhe mandej sërish, dhe sërish, dhe sërish. Ajo që keni në dorë është një det i kuq me vetëm disa pikëla blu aty këtu. Kjo është ajo që nënkuptoj kur them se universet jetë-lejuese janë në mënyrë të pallogaritshme të pamundur.

(3) Ai thotë, “Por probabiliteti që të gjithë këta njerëz gjenden këtu sonte, pra pikërisht këta njerëz, është me shumë gjasa i pamundur, dhe megjithatë ne gjendemi këtu!” Ky është një moskuptim i argumentit. Secili univers që përzgjidhet është njësoj i mundshëm, por ka gjasa të mëdha, mjaft të mëdha, që universi që zgjidhet të jetë jetë-lejues. Kjo është çështja. Është si një llotari ku ka miliarda, miliarda, miliarda gogla të zeza dhe një gogël të bardhë. Secila gogël që përzgjedh është njësoj e pagjasë, por probabiliteti që gogla që kapet të jetë e zezë është gjerësisht më e mundur se sa të jetë e bardhë. Në mënyrë të ngjashme, po të mbajmë parasysh pamundësinë e kushteve fillestare të universit, universi duhet të jetë i vdekur; nuk duhet të ketë fare jetë në univers. Fakti që nuk mund të shpjegohet mbi bazat e rastësisë apo të ligjit na lë projektimin si shpjegimin më të mirë se përse universi është i rregulluar kaq mirë për ekzistencën tonë.

## Argumenti i Tretë

Po në lidhje me vlerat objektive morale? Ai bie dakord se nuk ka vlera objektive morale, por ai thotë se vlerat janë gjëra që funksionojnë, përndryshe shoqëria do të shembet. Kjo nuk është plotësisht e vërtetë. Shikoni Gjermaninë Naziste. Në librin e tij, *Morality after Auschwitz*<sup>[21]</sup>, Peter Haas shtron pyetjen se si mund të ketë ekzistuar një shoqëri e tërë në të cilën shfarosja në masë e çifutëve dhe e ciganëve vazhdoi për një dekadë pa patur as edhe një protestë të vetme. Ai thotë që arsyeja është se një etikë e re kishte zënë vend në Gjermani, e cila nuk e përkufizonte holokaustin si të ligë, por si të mirë. Dhe ai nxjerr në pah se kjo etikë nuk mund të kritikohet nga brenda sepse së brendëshmi ishte e

pajtueshme. Ajo mund të kritikohet vetëm nëse ke një pikë përparësie dhe mbështetjeje transhendente për vlera morale. Sipas këndvështrimit të dr. Pigliucci's, përdhunimi, abuzimi me fëmijët, torturat, aparteidi, spastrimi etnik, fushat shfarosëse të Kamboxhas janë të gjitha moralisht indifirente sepse nuk ekziston asnjë e drejtë dhe asnjë gabim objektiv. Dhe unë nënshtroj faktin se kjo është thjesht e paqëndrueshme. Vlerat objektive morale ekzistojnë, gjë nga e cila logjikisht rrjedh se Zoti ekziston.

Shpresoja të ravijëzoja argumentin tjetër mbi jetën, vdekjen dhe ringjalljen e Jezuit gjatë kundërshtimit, por më ka mbaruar koha, dhe kështu do ta lë me kaq.

[Top](#)

## **Kundërshtimi i Parë i Dr. Pigliucci**

Përgjigja ime ka për të qenë: "Më tregoni një." Derisa të më tregoni një, ju s'mund të më akuzoni se jam dritëshkurtër sepse unë nuk dua të marr në konsideratë apo të pranoj ekzsitencën e njëbrirëshave. Unë do ta marrë në konsideratë atë, por para se unë ta pranoj atë, ju duhet të sillni një argument pozitiv.

## **Argumenti i Parë**

Në lidhje me këtë gjënë e zanfillës së universit: Dr. Craig tha se universi ka një shkak, dhe ka një fillim. Me aq sa jam në dijeni, kjo është e vërtetë (dhe unë po e pranoj këtë sepse astronomët dhe kozmologët ndërrojnë mjaft shpesh mendim, dhe gjërat kanë ndryshuar gjatë 20 apo 30 viteve të fundit, kështu që unë s'do të vija bast jetën time në kësi gjërash). Por le të supozojmë se në fakt universi pati një zanafillë dhe se faktikisht universi duhet të ketë patur një farë shkak. Por, kjo nuk nënkupton kurrësesi se shkak është ai të cilit ne i referohemi zakonisht si Zoti. Thjesht do të thotë se ka patur ndonjë shkak rreth të cilit ne nuk kemi shumë dijeni. Nuk nënkuptohet nga asnjë përvijim i imagjinatës se ky shkak ishte i ndërgjegjshëm, se kishte fuqi mbinatyrore, se ka gjithëpranishmëri, se është i gjithdijshtëm, dhe të gjitha 'gjithë'-t e tjerë që ju dëshironi. Këto dy gjëra thjesht nuk shkojnë me njëra tjetrën. Kjo thjesht do të thotë se ka një shkak, në rregull? Dr. Craig tha se kjo për pasojë nënkupton që ka një faktor të përveçëm. Dhe sërish unë po shtroj pyetjen, 'Dr. Craig, nga vjen ky faktor?' Përse mendon ai se ishte faktor i përveçëm e jo i përgjithshëm? Fundja fundit, ne mund të mos jemi kaq larg nga njëri tjetri sepse shkencëtarët bien dakord që duhet të ketë patur medoemos një shkak dhe ky shkak me shumë gjasa ishte i përgjithshëm. Është thjesht një çështje e të përkufizuarit se ç'nënkuptoni me 'shkak'.

## **Argumenti i Dytë**

Le t'i kthehemi kompleksitetit të universit dhe ekuilibrit të kushteve fillestare. Siç thashë më parë është vërtet e vështirë të vlerësohen mundësitë. Vlerësimet të cilave Dr. Craig iu referua si Parimi Antropik janë vërtet, vërtet të tepruara. Nëse pyesni një mori fizikantësh, siç kam bërë unë, ata do t'ju thonë se këto përlogaritje s'kanë asnjë farë baze. Ne thjesht nuk e dimë. Ne nuk dimë sa duhet. Është mjaft e lehtë të nxjerrësh nga mënga çdo numër që tregon se diçka është mjaft e pamundur. Nuk e di në e keni vënë re, por Dr. Craig nuk resht së parashtruar këto argumente probabilitiste – për shembull, probabilitetin e evolucionit të njerëzve. Dhe njerëzit që ai citon janë ose fizikantë ose kimistë, por jo biologë. A nuk ju duket e çuditshme kjo? Dua të them, problemi është ky: unë nuk ndjehem i kualifikuar, si biolog evolucionar që jam, të shkoj në laboratorin e një fizikanti dhe t'i them atij se si funksionon atomi. Kjo nuk është puna ime; kjo është puna e fizikantit. Më duket e çuditshme, në anën

tjetër, që fizikantët dhe kimistët nuk kanë kurrëfarë problemi që t'i hyjnë fushës së biologjisë, duke nxjerrë numrat prej mëngës së tyre, dhe duke mos dhënë ndonjë arsye të mirë se përse e bëjnë këtë. Është privilegji i tyre, sigurisht, ta bëjnë këtë – hulumtimet janë të hapura për gjithëkënd – por duhet patur një arsyetim i fortë për ta bërë këtë.

Meqë ra fjala, unë do të doja të përmendja se ju s'duhet ta besoni kurrë diçka thjesht sepse e thotë dikush, pavarësisht sa i rëndësishëm apo i famshëm është ky person. Rasti në fjalë: Dr. Craig ka cituar për të disatën herë Fred Hoyle. Fred Hoyle është një astronom britanik mjaft i respektuar dhe i njohur. Ai ka nxjerrë jo pak ide të çuditshme përgjatë karrierës së tij. Faktikisht, ai ka nxjerrë kaq shumë ide të çuditshme në karrierën e tij sa që Shoqata Britanike e Astronomisë i ka dhënë atij, dhe vetëm atij, një medalje për numrin më të lartë të teorive të propozuara gjatë një karriere. Vini re që ky është një fakt domethënës sepse Fred Hoyle, për shembull, ishte një nga njerëzit që kundërshtoi teorinë e Big Bangut rreth origjinës së universit, dhe Shoqata Britanike e Astronomisë i ka dhënë Fred Hoyle-it këtë medalje për shkak se ç'është e vërteta kemi shumë njerëz që punojnë mbi teorinë e Big Bangut, dhe ne kemi mësuar kaq shumë rreth teorisë së Big Bangut pjesërisht në sajë të faktit se shumë njerëz ngelën të zhgënjyer nga Hoyle-i kur ai propozoi teorinë e tij. Pra ju e dini, propozimet e gabuara kanë ndonjëherë rezultate shumë të mira dhe pozitive. Kjo nuk do të thotë se ju duhet t'u besoni atyre.

### **Argumenti i Tretë**

Le t'i kthehemi kësaj gjëse së moralit objektiv. Mendoj se këtu ka deri diku një farë koklavitje me termat. Edhe një herë, nuk bëhet fjalë për 'A ekziston një moral objektiv?' Ne e dimë se nuk ka. Ka disa elementë të vetë moralit tuaj që nuk ndahen nga qëniet e tjera njerëzore. Pra ose ju shtireni aq sa mendoni se morali juaj për çfarëdolloj arsyeje është i vetmi i saktë, ose gjithëkush tjetër në botë është në gabim.

Unë mendoj se kjo është shtirje. Sigurisht, ka disa parime universale për të gjitha qëniet njerëzore. Për shembull, unë u thashë studentëve të mi gjatë një leksioni biologjie se ka disa gjëra që qëniet dhe shoqëria njerëzore nuk do t'i miratojnë kurrë për shkak të mënyrës se si janë sendërtuar shoqëritë njerëzore. Njëra prej tyre, sigurisht, është vrasja, një tjetër, sigurisht, është përdhunimi. Mirëpo, ajo që ne quajmë vrasje apo përdhunim apo, faktikisht, edhe vrasja e fëmijëve është tejet, tejet e zakonshme në mesin llojeve të ndryshme të kafshëve. Luanët për shembull, kryejnë vrasje fëmijësh rregullisht për shkak se dëshirojnë që të jenë të sigurtë se pasardhësi i vogël që po rritet nga luanesha është tyri dhe jo i dikujt tjetër. Tani, a duhen harruar këto veprime? Unë madje nuk e di se ç'do të thotë kjo sepse luani nuk e kupton se çfarë është morali, kjo është e sigurtë.

Morali është shpikje e qënieve njerëzore. Një shpikje mjaft e mirë. Unë nuk po sugjeroj që ne duhet të braktisim moralin. Nuk po sugjeroj, për t'iu afruar çështjes, se ne duhet të të braktisim etikën. Etika është një mënyrë përsoshmërisht e vlefshme e të menduarit të gjërave. Ne mund të pajtohemi të gjithë si një shoqëri se ka gjëra që janë të gabuara dhe gjëra që janë të mira. Ne mund të veprojmë ndaj tyre, dhe ne mund t'i përforcojmë ato gjëra, por nuk ka asnjë fuqi madhore apo asnjë arsye më të lartë që të na thotë se kjo është e drejtë apo e gabuar. Për fat të keq, ne jemi vetëm; ky është opinionimi im modest. Mua do të më pëlqente vërtet që dikush të zbriste nga qielli dhe të më thoshte se ç'është e drejtë dhe ç'është e gabuar. Jeta ime do të ishte shumë, shumë më e thjeshtë. Fatkeqësisht, kjo nuk ndodh.

### **Argumenti i Katërt**

Po në lidhje me këto fakte historike të Jezuit që krishterimi i shpjegon deri diku? Epo, ka disa gjëra që

unë do të doja të thoja rreth kësaj. Kjo, padyshim, është paksa në anën e argumenteve shkencore. Është vërtet e vështirë të bëhet një shkencë e historisë. Në disa raste mund të bëhet, por pa dyshim me një ngjarje unike historike është e vështirë. Kjo është një nga kufizimet e shkencës. Shkenca, meqë ra fjala, ka caqe. Shpresoj që kjo do të bëhet e qartë nga biseda e mbrëmjes së sotme. Unë nuk po e mbroj shkencën si zëvendësues të një Zoti të gjithëfuqishëm. Por ka disa gjëra që ne mund të marrim me mend nga çka dimë në lidhje me origjinën e mitologjive dhe origjinën e fesë në përgjithësi.

Një gjë është e sigurtë, sipas dokumenteve romake të epokës, Jezui ishte thjesht njëri nga njerëzit e shumë që thanë para njerëzve se ishin profetë dhe se kryenin mrekullira. Ka patur një mori syresh. Ai ishte vetëm njëri prej të shumtëve. Ai me shumë gjasa ishte i talentuar, andaj marka e tij e veçantë e fesë përfundimisht pati sukses. Por kishte shumë të tillë; ndaj, përse të mendohet se ai ishte i veçantë? Thjesht si pasojë e rastësisë historike ngjau që ai u bë një nga më të suksesshmit? I tillë ishte Muhamedi, Islami është jashtëzakonisht i suksesshëm; faktikisht, është feja e dytë më e madhe nga përhapja në botë. A e kanë, pra, muslimanët gabim dhe a janë jashtë rruge vetëm sepse atyre u ka ndodhur të besojnë në profetin e gabuar? Mbi ç'baza bëhet një gjykim i tillë?

Tani, po në lidhje me këto mrekullira? Përgjatë gjithë historisë, madje dhe sot, ne mund të gjejmë një mori njerëzish që kanë pretenduar se bëjnë mrekullira, që kanë pretenduar të jenë profetë. Mendoj se ju mund të gjeni adresat dhe t'u dërgoni email njerëzve që pretendojnë se janë profetë dhe mrekullirapunues. A do t'u besoni atyre? Shkurt, unë s'u besoj – jo pa parë fillimisht diçka me sytë e mi. Tani, sigurisht, ka njerëz që pretendojnë se kanë parë me sytë e tyre mrekullira, por njerëzit gjithashtu pretendojnë se janë rrëmbyer nga alienë apo se kanë para zana, apo xhuxha, apo çfarëdo tjetër që të dëshironi. Tani, meqë jemi këtu, ndonëse unë nuk u besoj UFO-ve dhe rrëmbimeve nga alienët, unë mendoj se ato janë më të besueshme se sa mrekullitë. Një gjë është e sigurtë, një racë alienësh që zbresin në tokë dhe ndërhyjnë në punët tona personale – ndonëse ju mund të pyesni, 'Përse do ta bënin ata një gjë të tillë, përse do të udhëtonin gjithë këtë rrugë thjesht për të rrëmbyer një grusht njerëzish nga fshatrat e Ajouas?' – dhe po të lemë mënjanë këtë mëdyshje, ata nuk shkelin asnjë nga ligjet fizike që unë njoh. Atyre mund t'u jetë dashur një kohë e gjatë për të udhëtuar me shpejtësinë e dritës pa thyer teorinë e relativitetit për të ardhur në këtë planet, por ata mund t'ia kenë dalë mbanë; nuk ka asnjë pikëpyetje rreth kësaj. Ata nuk po thyejnë asnjë nga ligjet e fizikës. Kurse mrekullitë shkelin ligje. Tani, s'ka asgjë të gabuar as me këtë, dhe ju ende mund t'u besoni mrekullive. Problemi është se ju s'mund të përzgjidhni; ju s'mund të mendoni se, në mungesë të mrekullive, natyralizmi funksionon pa reshtur dhe mandej një mrekulli ndodh kur ju volit juve. Sepse shpjegimi më i mundshëm për këtë është se ka ndodhur diçka për të cilën ju nuk keni asnjë ide tjetër se çfarë ka qenë, dhe unë mendoj se është më modeste dhe më pak e shtirur, nëse dëshironi të përdorni këtë term, të thoni thjesht, 'Nuk e di'. Kjo s'ka asgjë të keqe. 'Nuk e di' është më mirë se sa të thuash, 'Epo, unë do të sajoj një histori të tërë rreth asaj që mund të ketë ndodhur, dhe ky është rezultat i një qenieje madhore, për të cilin unë s'di asgjë dhe s'mund të di asgjë.'

## **Argumenti nga Papërsosmëritë**

Dr. Craigu në fund nxorri në pah se është pretendim i tepruar nga ateistët, apo jo-teistët, siç më pëlqen mua të më quajnë, për të hamendësuar rreth mendjes së Zotit. Sigurisht, është pretendim i tepërt, por është një dredhi. Këtu qëndron dredhia. Unë mund të them se nuk pretendoj së tepërmi për të njohur mendjen e Zotit, por megjithatë mua më duhet ende një shpjegim se përse Zoti po i bën gjërat në këtë apo atë mënyrë. Të rikthehesh thjesht në, 'Epo, ai e bëri atë sepse kështu e ndjeu ai' apo 'Ai e di më mirë' sërish nuk është shpjegim. Nuk është e mjaftueshme nga një pikëpamje intelektuale. Mund të

jetë fort mirë e vertetë. Fundja, ndoshta minjtë në laboratorët e të gjithë botës vrasin mendjen se ç'dreqin po u bëjmë në atyre, duke i vënë të vrapojnë rreth e përçark, dhe duke testuar inteligjencën e tyre. Ata me gjasë e mendojnë kështu, dhe ata me siguri nuk kanë tru për të kuptuar se ç'po ndodh. Të paktën, kjo është ajo çka mendojmë ne. Por ju duhet të bëni pyetjen, dhe nëse përgjigja është, 'Nuk e di' atëherë druaj se pozicioni teist nuk ka ndryshuar aspak për mirë që nga fillimi.

## **Kundërshtimi i dytë i Dr. Craig Dr. William Lane Craig**

### **Çështja e dytë**

*Mungesa e evidencës nuk është domosdoshmërisht evidencë e mungesës.* Për shembull, ne nuk kemi asnjë evidencë pozitive për një epokë të hershme të zgjerimit domethënës në historinë e universit, dhe nëse u hidhni një sy kozmologëve të shumtë, ata besojnë se një epokë e tillë e zgjerimit domethënës faktikisht ka ekzistuar. Mungesa e evidencës nuk është provë se kjo *nuk* ka ekzistuar. Dhe vazhdimisht në argumentet që Dr. Pigliucci dha për të përgënjeshtuar hipotezën e Zotit, ai m'u kthye mua duke thënë se unë nuk kam parashtruar prova. Por kundërshtimet e tij, pretendon ai, *përgënjeshtrojnë* Zotin. Sikur kjo të ishte e vërtetë, ai duhet parashtronte provat e tij. Gjithsa duhet të bëj unë është të tregoj se këto kundërshtime janë pa konkluzion.

### **Argumenti nga Papërsosmëritë**

Kështu, për shembull, merrni argumentin e tij nga papërsosmëria. Unë u përgjigja me tre pika: (1) Ai presupozon një teori statike të krijimit, por kreacionistët pranojnë se ka mikroevolucion. Ai nuk iu përgjigj kësaj pike. (2) Unë thashë se kjo presupozon që dihet se ç'do të bënte Zoti, gjë e cila është pretendim i tepërt. Dhe ai thotë se kjo është e vërtetë, por ne duhet të kemi një përgjigje. Jo, aspak; *ai* mendon se ju duhet të jeni në gjendje të presupozoni se ç'do të krijonte Zoti sikur ai të ekzistonte, për të sjellë kundërshtimin. Këtu, unë jam ai që thotë, 'Unë nuk e di, dhe as ti nuk e di; rrjedhimisht ky kundërshtim është pa konkluzion.' (3) Unë thashë se përsosmëria është një term relativ. Një orë e cila nuk funksionon në përsosmëri mbetet projektim. Ai s'iu përgjigj kësaj.

Unë mandej dhashë argumentin nga evolucioni dhe nxorra në pah se, përveç Zotit, është pothuajse e pamundur të mendohet se përzgjedhje natyrore dhe mutacionet gjenetike mund të kenë rezultuar në atë lloj kompleksiteti biologjik që ne shohim. Ai nuk e kundërshtoi këtë argument; thjesht tha se unë nuk citova biologë. Por shikoni, ai nuk mohoi përllogaritjet apo argumentin. Në fakt, Barrow dhe Tipler në po të njëjtin libër vërejnë se sot ka një konsensus ndërmjet biologëve evolucionarë se jeta e aftësisë së krahasueshme të përpunimit të informacionit e *homo sapiensëve* është kaq e pamundur saqë nuk ka gjasa të evoluojë askund tjetër në universin e dukshëm. [22] Kjo është ajo që raportohet si konsensus ndërmjet biologëve sot.

### **Kundërshtime të Tjera**

Ai hoqi dorë nga argumenti i tij i regresit, hoqi dorë nga argumenti i 'veprës së Natyralizmit', hoqi dorë nga argumenti i Problemit të Ligësisë, hoqi dorë nga Argumenti i Arkës së Noes. Pra unë shpresoj se sot ju nuk keni parë ndonjë arsye bindëse për të menduar se hipoteza e Zotit është e rreme. Dr. Pigliucci thjesht ka dështuar në përgënjeshttrimin e kësaj hipoteze.

### **Pyetja e Parë**

Tani, po në lidhje me arsyet rreth të besuarit në ekzistencën e Zotit?

### Argumenti i Parë

(1) *Zanafilla e universit*. Këtu ai pranon premisat se gjithçka që fillon së ekzistuari ka një shkak, dhe se unversi filloi së ekzistuari. “Por përse,” thotë ai, “të mendohet se shkak është Zoti?” Unë i dhashë argumentet në fjalimin tim të parë. Tregova se është deduksion nga një shkak hapësire dhe kohe që shkak të jetë i pakohë dhe pa hapësirë. Rrjedhimisht, nuk mund të jetë asgjë fizike dhe materiale që kalon në kohë dhe hapësirë. Duhet të jetë medoemos i pandryshueshëm. Dhe unë argumentova se duhet të jetë i përveçëm meqënëse përndryshe ju nuk mund të shpjegoni se si një pasojë e përkohshme mund të fillojë nga një shkak i përgjithshëm, e i pakohë. Dhe ai nuk rrëzoi asnjërin prej këtyre argumenteve. Pra në formulimin e argumentit që dhashë unë mendoj se u jam përgjigjur të gjitha kundërshtimeve të tij.

### Argumenti i dytë

(2) Po në lidhje me *rendin kompleks të universit*? Unë shpjegova teorinë e probabilitetit. Unë vërtet tregova se përse shembulli i tij i njerëzve në dhomë është analogji me të meta. “Por,” thotë ai, “shikoni, s’ka asnjë bazë për këto përlllogaritje. Ne nuk e dimë se këto gjëra janë vërtet të pamundura.” Ai, në të vërtetë, po ju sugjeron se në njëfarë mënyre një univers jetë-lejues është i domosdoshëm, se nëse ne jemi në dijeni të ndonjë Teorie të Gjithçkaje, ne do të shihnim se jeta domosdoshmërisht ekziston. Dhe kjo është një hipotezë jashtëzakonisht e pabazë. Astrofizikanti, Paul Davies, thotë:

Nuk ka absolutisht asnjë evidencë në favor të saj. . . . Edhe sikur ligjet e fizikës të ishin unikalë, prej kësaj nuk rrjedh se universi fizik në vetvete është unikal. . . . ligjet e fizikës duhet të jenë të rritur nga kushtet fillestare kozmike... Në idetë e tanishme rreth ‘ligjeve të kushteve fillestare’ nuk ka asgjë që të tregojë sado pak se përputhja e tyre me ligjet e fizikës do të përfshinte unikalitetin. Krejt e kundërt. . . duket, mandej, se universi fizik nuk ka përse të jetë ashtu siç është: mund të kishte qenë ndryshe. [23](#)

Dhe, në fakt, siç thashë, kur ndryshoni ato konstante, ato kushte, ato ligje, ju zbuloni se po ecim në tehun e thikës. Zanafilla e universit është sikur Empire State Building të vinte në ekzistencë nga hiçi. Ja me çfarë na përngjan hipoteza ateiste, nëse ata besojnë se kjo vërtet ndodhi në sajë të rastësisë. Dhe mua më duket shumë më e besueshme hipoteza e projektimit.

### Argumenti i Tretë

(3) Po në lidhje me *moralin objektiv*? Këtu dr. Pigliucci është qartazi në një dilemë ekzistenciale: ai pohon se moraliteti nuk është objektiv – është shpikje e qënieve njerëzore – por ai e ka të pamundur të thotë se rrjedhimisht gjithçka ecën. Ai dëshiron të kapet pas vlerave morale. Por, shikoni, për një ateist këto vlera janë thjesht tym në ajër: ato nuk kanë asnjë bazë objektive. Në ateizëm, vlerat morale janë thjesht konvencione shoqërore. Ju mund të zgjidhni të ecni me të kuqen dhe të ndalonit me jeshilen. Ato janë thjesht shpikje njerëzore, efekte anësore të evolucionit socio-biologjik. Por kjo do të thotë se një shoqëri si Gjermania Naziste apo Afrika e Jugut, ku praktikoheshin aparteidi, apo ajo që ka ndodhur në Kamboxha në fushat vrasëse, se ato nuk janë moralisht të gabuara, që do të thotë se ata janë moralisht të ndryshëm. Dhe unë, të paktën, e kam të pamundur ta besoj këtë. Mua më duket shumë më bindëse se ka një të drejtë dhe një të gabuar objektive; për shembull, torturimi i foshnjave për kënaqësi është e gabuar. Dhe nëse ju pajtoheni me mua sonte se kjo është moralisht e objektivisht e



gabuar, atëherë ju do të pajtoheni me mua se rrjedhimisht Zoti ekziston. Sepse ai pranon se nëse ne nuk do të kishim Zot, këto gjëra nuk janë objektivisht të gabuara, por janë konvencione njerëzore.

## Argumenti i Katërt

(4) Po në lidhje me *jetën, vdekjen dhe ringjalljen e Jezuit*? Këtu ai pyet, 'Përse të mendohet se Jezui ishte i veçantë?' Shumë e thjeshtë: për shkak të evidencës për ringjalljen e tij! Asnjë themeluesi të ndonjë feje tjetër në histori nuk i është mveshur një gjë e ngjashme. "Por," thotë ai, 'A nuk është arbitrare të besohet në një mrekulli në këtë rast nëse nuk beson në mrekullitë në rastet e tjera të shumta?' Aspak! Duhet të besoni në një mrekulli, mendoj unë, kur (1) Nuk gjindet asnjë shpjegim natyralist i fakteve për të shpjeguar bindshëm faktet, dhe (2) Ka një shpjegim mbinatyror të sugjeruar në kontekstit fetaro-historik në të cilin ka ndodhur ngjarja. Ringjalla e Jezuit është domethënëse jo thjesht sepse dikush u kthye nga të vdekurit, por sepse Jezui i Nazaretit i cili pretendonte se ishte zbulesa absolute nga Zoti, u kthye nga të vdekurit. Dhe domethënëse këtu është se Dr. Pigliucci nuk ka qenë në gjendje të mohojë ndonjërin prej këtyre tre fakteve që pjesa më e madhe e kritikëve të Dhjatës së Re sot refuzojnë t'i braktisin: varri i zbrazur, shfaqjet e ringjalljes, dhe zanafilla e besimit të dishepujve. Këto janë faktet historike. Tani, ju mund të ndiqni agnosticizmin nëse dëshironi. Ju mundeni mjaft mirë të thoni, 'Epo, unë nuk e di shpjegimin.' Por unë pa dyshim mendoj se një i krishterë ka plotësisht të drejtë të thotë, 'E dini, mua më duket se ata njerëz kanë thënë të vërtetën,' se shpjegimi më i mirë është që Jezui *vërtet* u kthye nga të vdekurit. E kështu ju mund të mbeteni agnostikë nëse dëshironi, por mua si historian më duket se kam plotësisht të drejtë nga pikëpamja e arsyes të them se shpjegimi më i mirë është se Jezui u kthye nga të vdekurit.

## Arsyeja e Pestë

(5) Dhe së fundmi, *përvoja e drejtëpërdrejtë e Zotit* nuk është diskutuar aspak sonte në këtë debat. Por unë mendoj se dikush mund të mësojë drejtëpërdrejtë se Zoti ekziston.

[Top](#)

## Kundërshtimi i Dytë i Dr. Pigliucci

Ju faleminderit. Pikë së pari, më lejoni t'i kujtoj publikut dinamikën e këtij debati. Arsyeja përse unë nuk po i përgjigjem drejtëpërdrejtë atyre pak gjërave të fundit që ju sapo dëgjuat, është sepse unë po përdor shënimet e mia të mëparshme dhe po i përgjigjem argumenteve të mëparshme të dr. Craig. S'kemi shumë kohë. Do të na duhej një numër i pafund kundërshtimesh për t'i shkuar deri në fund kësaj, dhe unë mendoj se as durimi juaj nuk do të zgjasë aq shumë. Gjëra tjetër është se unë vërtet nuk hoqa dorë nga argumentet. Kur unë them një argument, mendoj se ai është i mjaftueshëm. Mund të mendoni rreth kësaj, dhe ne mund të flasim në lidhje me të më vonë, dhe ju mund të bëni pyetje. Unë po përpiqem të eci përpara dhe t'u përgjigjem disa prej argumenteve të tjera; pra, nëse nuk kthehem nga e para në të njëjtën pikë, kjo ndodh sepse unë më mirë do të përdorja kohën time për të thënë mendime të reja, nëse kjo është e mundur.

## Pyetja e dytë

### Argumenti nga Papërsosmëritë

Mirë pra, tani më lejoni t'u kthehem disa prej argumenteve të mëparshme të Dr. Craig. Ai pati një

mundësi në kurriz të argumenteve të mia të përgënjeshtimit të Zotit. Ai tha se, 'Epo, sigurisht, është e vërtetë se ne jetojmë në një univers të papërsosur. Edhe çfarë? Papërsosmëria nuk është e papajtueshme me Zotin.' Oh, për drejt, unë jam rritur si katolik, dhe më kanë mësuar se Zoti është i përkryer! Tani dikush po më thotë se nga këndvështrimi i krishterë papërsosmëria s'ka asnjë mangësi! Epo, këtë e kam të vështirë ta besoj. Kjo nuk përshtatet tamam me atë çka unë kam mësuar rreth Zotit të krishterë. Por ndoshta unë jam gabuar.

Dr. Craig tha se ne presupozojmë se e dimë çfarë dëshiron Zoti. Jo, aspak! Ne thjesht po bëjmë pyetjen. Dhe, e përsëris, nëse përgjigja është, 'Unë nuk e di,' druaj se pozicioni teist është në anën e dobët sepse — mendoni rreth kësaj: përse ndodh që ne të gjithë jemi këtu sonte? Unë jam i sigurt se secili person ka një arsye të ndryshme, të veçantë për të qenurit e tij këtu sonte, por ajo çka unë mendoj se me shumë gjasa unifikon këtë publik, përfshirë folësit, moderatorin, dhe të gjithë të tjerët, është se ne kemi një kureshtje të madhe për të zbuluar se çfarë po ndodh në pjesën tjetër të universit — gjë që do të thotë se ne duhet t'u përgjigjemi pyetjeve. E pra, po, ne po rrekemi të hetojmë në brendinë e mendjes së Zotit — këtu është i gjithë thelbi i debatit —, dhe nëse ju thoni se mendja e Zotit është e mbyllur dhe se nuk ka asnjë rrugë hyrje për te ajo, atëherë, ky është fundi i debatit. Ju mund të mbani besimin tuaj, sigurisht; kjo është qartazi privilegji juaj, por ju nuk i keni çuar përpara as edhe një grimcë njohuritë që qëniet njerëzore kanë rreth universit dhe vendit të tyre në të.

Le t'i kthehemi këtyre gjërave numerologjike. Të gjithë këto probabilitete — për shembull. Probabiliteti i evolucionit të qënieve njerëzore —, vërtet po lëshohen nëpër tym. Nuk ka absolutisht asnjë konsensus se qëniet njerëzore janë kaq shumë të pagjasa sa që kurrësesi nuk ka mundësi që të evoluojnë. Asnjë biolog evolucionar nuk e ka thënë ndonjëherë këtë. Me këtë, ata duan të thonë se qëniet njerëzore janë vetëm një rezultat i mundshëm i trajektoreve të ndryshme të mundshme evolucionare. Le të themi se ka një milion trajektore të mundshme që mund të kenë filluar miliarda vite më parë kur zuri fill jeta në tokë; me 'të pamundur' ata duan të thonë se ka shumë gjasa që vetëm një grusht nga këto trajektore mund të shpiejnë faktikisht në diçka të krahasueshme me qëniet njerëzore. Edhe çfarë? Nëse në vend të qënieve njerëzore këtu përreth, le të themi, për shembull, 65 milion vjet më parë, dinosaurët nuk do të shuheshin për shkak se një meteor rastisi që nuk i goditi ata, atëherë, ne sonte do të kishim një mbledhje të shkëlqyer zvarranikësh që do të flisnin rreth faktit se ekzistojnë këto krijesat e vogla të quajtura gjitarë që në njëfarë mënyre kanë dështuar të evoluojnë dhe që dikur kanë qenë konkurrentë për ne dinosaurët. Pra kjo është ajo që biologët nënkuptojnë duke thënë se ne jemi të pamundur, duke nënkuptuar se rezultatet specifike që ju po vështroni janë të pamundura. Nuk nënkuptojnë aspak se 'Rrjedhimisht, nuk do të mund të kishte ndodhur.' Sigurisht, mund të ketë ndodhur! Ne e dimë se si ndodhi, dhe vërtet ndodhi! Ne jemi këtu, por mund të kishte ndodhur në një larmi mënyrash të tjera, të gjitha njësoj të barbart. Nuk do të kishte asfarë rëndësie për pjesën tjetër të universit.

Duke folur për pjesën tjetër të universit, ne përfundimisht e rrokëm se është shumë e pamundur që universi në tërësi të ketë filluar ashtu siç është. Rrjedhimisht, me sa duket ka një univers të papranueshëm që mund të bartë jetën. Siç thashë, ky faktikisht është një argument mjaft i vështirë për t'u bërë mbi baza probabiliste. Por le të supozojmë se është kështu; le të supozojmë se, po, është shumë e pamundur që jeta ashtu siç e njohim ne në Tokë të ketë filluar në ndonjë lloj tjetër universi. Dhe kjo, e përsëris, për ç'lloj projektuesi duhet të ishte evidencë? Mendoni rreth kësaj. Nëse ju keni sadopak njohuri rreth astronomisë, nëse ju keni parë ndonjëherë ndonjë dokumentar rreth astronomisë, ju e dini se ka një qind miliardë yje vetëm në galaktikën tonë, dhe numërimi më i fundit flet për rreth një qind miliardë galaktika (dhe me shumë gjasa ky është një nënvlerësim i madh) në

pjesën tjetër të universit. Dhe e gjitha kjo për ne? Unë mendoj se kjo është vërtet pretendim i tepruar. Mendoni ç'shpërdorim, nëse ju do të ishit një projektues! Ç'lloj projektimi po bëni? Ju po flakni tutje jo 99, por 99.99 dhe kështu me radhë radhë – unë mund të vazhdojë me 9-a për pjesën tjetër të mbrëmjes – përqind të asaj që ju keni bërë vetëm për të na prodhuar ne! Dhe ç'rezultat, pale – asnjë ofendim, sigurisht! Unë jam pjesë e këtij projektimi gjithashtu.

### **Argumenti pragmatik për natyralizmin**

Dr. Craig gjithashtu nxorri në pah se natyralizmi funksionon në praktikë por në fakt nuk teston kurrë supozimet e tij. Unë kam prirjen të mos bie dakord. Ka një mori shkencëtarësh që gjithashtu kanë këtë qëndrim – me fjalë të tjera, se një shpjegim natyralist i botës është një supozim themelor i shkencës, dhe rrjedhimisht gjithçka tjetër rrjedh prej saj. Mendoj se kjo ka shumë mangësi. Është një supozim, pa dyshim. Dua të them, sa herë që unë jam në zyrë dhe, për shembull, një student më paraqet rezultatet e një eksperimenti, zakonisht ky student jep një shpjegim për eksperimentin në fjalë – p.sh. përse kjo lulja lulëzoi sot dhe jo një muaj më vonë – që nuk evokon një tip të veçantë Zoti. Asnjë student nuk vjen tek unë për të më thënë se kjo ndodhi pasi e ka bërë Zoti. Dhe unë nuk do ta pranoja këtë lloj shpjegimi. Përse? Jo sepse është e pamundur, por sepse, edhe njëherë, ne kemi nevojë për argumente shumë bindëse që ka ndodhur kështu, për shkak se ne e dimë mjaft mirë se si funksionojnë hormonet te bimët dhe përse bimët lulëzojnë më vonë apo më herët. Ky shpjegim është i mjaftueshëm për mua. Kjo nuk do të thotë se nuk ka shpjegime të tjera të mundshme dhe, ç'është e vërteta, as shpjegime që janë të vërteta. Por nga e dimë ne?

Epo, një mënyrë për ta ditur është se një ditë unë gjej një bimë që ka një sjellje krejtësisht dhe tërësisht të kundërt me çdo ligj biologjik, kimik dhe fizik që ne njohim. Atëherë unë duhet të vë seriozisht në pikëpyetje supozimin natyralist. Nëse ne do të ishim duke jetuar në një univers që nuk do të kishte asnjë parashikueshmëri apo një nivel më të ulët parashikueshmërie, ku mrekullitë ndodhin në çdo moment të veçantë pa asnjë paralajmërim, atëherë supozimi natyralist nuk do të funksiononte dhe universi nuk do të kishte më shumë kuptim sesa ka tani. Arsyeja përse universi është i parashikueshëm, do të mendoja unë, është sepse supozimin natyralist funksionon. Në çastin kur universi do të reshtë të silltet siç ne mendojmë se është i supozuar të silltet, atëherë ju keni prova pozitive dhe evidencë pozitive për një shpjegim mbinatyror. Deri më tani unë nuk e kam parë këtë. Ju faleminderit.

### **Fjala mbyllëse e Dr. William Lane Craig**

Unë sigurisht shpresoj që t'ju ketë pëlqyer debati i kësaj mbrëmjeje po aq sa mua! Mendoj se ishte një shkëmbim mjaft i frytshëm.

### **Pyetja e Dytë**

#### **Argumenti nga Papërsosmëritë**

Së pari, ç'argumente kemi parë që *përgënjeshtrojnë* hipotezën se Zoti ekziston? Në fjalimin e fundit, në parim dëgjuam sërish të ashtuquajturin 'argumentin e papërsosmërisë'. Por, këtu, mendoj unë, u bë e qartë nga komentet e Dr. Pigliuccit se argumentet e tij bazohen mbi supozimin e rremë se sipas teizmit bota është e përkryer. Sinqerisht, nuk arrij ta imagjinoj se nga e ka nxjerrë ai këtë ide. Si të krishterë ne besojmë se *Zoti* është i përkryer, por jo se *bota* është e përkryer. Hidhni një vështrim tek Zanafilla, ndërsa Zoti pa se krijimi ishte 'i mirë'. (24) Dhe mendoj se pa dyshim është i mirë! Por ideja se është

një makinë e përkryer funksionale nuk është pjesë e teologjisë apo e teizmit të krishterë. Dhe pa këtë supozim, i gjithë argumenti i tij kthehet në tym.

Sa i përket argumentit në lidhje me evolucionin, ai më keqçitoi. Ai tha se nuk ka asnjë konsensus që *qëniet njerëzore* nuk do të mund të kenë evoluar prej rastësisë. Argumenti im nga Barrow dhe Tipler thoshte se ka një konsensus në mesin e të gjithë biologëve evolucionarë se jeta e ndjeshme që është e krahasueshme me *homo sapiensin* në aftësinë e përpunimit të informacionit është kaq e pamundur sa që nuk ka asnjë gjasë që të ketë evoluar ndokund tjetër në universin e dukshëm.<sup>[25]</sup> Dhe, rrjedhimisht, ju nuk mund ta përdorni evolucionin si një argument kundër teizmit. Përkundrazi, evolucioni është faktikisht argument *për* teizmin sepse është kaq i pamundur sa që nuk ka asnjë gjasë që të ketë ndodhur në mungesë të një Projektuesi mbikëqyrës.

### **Argumenti pragmatik për Natyralizmin**

Së fundmi, ai argumentoi se natyralizmi është i vërtetuar çdo ditë, dhe se ai funksionon. Unë do të thoja se kjo thjesht vërteton se ka ligje natyrore. Por kjo është në përputhje me idenë se ka një Krijues i cili ka bërë një univers që funksionon normalisht sipas ligjeve natyrore.

Pra, asnjëri nga këto argumente nuk ofron terren të mjaftueshëm për të menduar se hipoteza e Zotit është e rreme. Në fakt, nga ky aspekt i debatit janë shfaqur dy argumente *për* ekzistencën e Zotit krahas të pestëve që unë dhashë, gjegjësisht, (1) argumenti nga evolucionin dhe (2) argumenti nga ekzistenca e së ligës. Pra, unë falenderoj Dr. Pigliuccin që më dha dy argumente të tjera gjatë debatit të sotëm për ekzistencën e Zotit.

### **Pyetja e parë**

Dhe tani, po në lidhje me arsyet që *vërtetojnë* hipotezën e Zotit?

### **Argumenti i Parë**

Së pari, unë argumentova se Zotin e kërkon origjina e universit. Ne pamë se çfarëdo që fillon të ekzistojë e ka një shkak; universi filloi së ekzistuari, dhe rrjedhimisht duhet të ketë një shkak transhendent, të përveçëm të universit. .

### **Argumenti i Dytë**

Së dyti, unë argumentova se rendi kompleks i kushteve fillestare të universit të çon tek Zoti si Projektues përgjatë universit. Dhe këtu Dr. Pigliucci tani thotë se, 'Ky është një shpërdorim i madh i hapësirës! Sa i gjerë është universi!' Aspak! Hapësirat yjore janë të domosdoshme në mënyrë që yjet të gatuajnë elementët e rëndë që janë të domosdoshëm për ekzistencën e jetës në tokë; dhe në mënyrë që të jetë aq i vjetër, universi duhet të jetë zgjeruar 15 miliardë vjet. Pra përmasa e universit është e lidhur me moshën e yjeve, gjë e cila është e lidhur me vendet e zjarra të domosdoshme për të bërë elementet që lipsen për jetën inteligjente. Dhe sinqerisht, si teist unë mund të argumentoj se gjetkë në univers mund të ketë jetë që është e krijuar nga Zoti. Nga e dimë ne se kjo *është* shpërdorim hapësire? Ndoshta Zoti ka krijuar jetë gjetkë. Por kudo që ekziston jeta, gjithçka varet nga ai rregullimi i imtësishëm që është i pranishëm në vetë Big Bangun, të cilin askush nuk e ka patur të mundur ta shpjegojë me anë të rastësisë.

## Argumenti i Tretë

Së treti, vlerat morale objektive ekzistojnë. Sërish, ne pamë se në mungesë të Zotit ne biem në nihilizëm moral: nuk ka asnjë të drejtë apo gabim. Nëse ju besoni se ka vlera morale objektive, atëherë, mendoj unë, ju të gjithë do të pajtoheni me mua se Zoti ekziston.

## Argumenti i katërt

Në fund, sa i përket jetës, vdekjes dhe ringjalljes së Jezuit, unë mendoj se kam treguar që ringjallja është shpjegimi më i mirë i atyre tri fakteve të pranuar nga shumica e studiuesve të Dhjatës së Re sot.

## Argumenti i Pestë

Në fund, përvoja e drejtëpërdrejtë e Zotit. Më lejoni të them vetëm këtë: unë nuk jam rritur në një shtëpi të krishterë apo në një familje që shkonte në kishë. Por kur u bëra adoleshent, fillova të bëja pyetjet e mëdha në jetë – rreth kuptimit të jetës dhe vdekjes – dhe gjatë kërkimit për përgjigjet unë fillova të lexoja Dhjatën e Re. dhe në personin e Jezuit zbulova një figurë që më rroku dhe më mbërtheu. Fjalët e tij bartnin hallkën e të vërtetës. Dhe pas një periudhe prej 6 muajsh të kërkimit shpirtëror më të dendur – për t'i rënë shkurt —, unë thjesht ia dhashë jetën time Zotit, dhe përjetova një lloj rilindjeje të brendshme. Zoti u bë një realitet i gjallë i drejtëpërdrejtë në jetën time, një realitet që nuk më ka braktisur kurrë. Dhe unë thjesht do t'ju sfidoj: nëse ju vetë do të dëshironit të njihnit Zotin në këtë mënyrë, filloni të bëni atë që bëra unë. Lexoni Dhjatën e Re. Unë besoj se ajo mund të ndryshojë jetën tuaj pikërisht në atë mënyrë siç ndryshoi jetën time.

## Fjala mbyllëse e Dr. Massimo Pigliucci

### Pyetja e dytë

Pikë së pari, Dr. Craig tha se unë po kërkoj barrën e provës që bie mbi të, por se njëkohësisht unë po lë të kuptohet se mund të përgënjeshtroj Zotin. Le të jemi më të saktë. Unë thashë dy gjëra të ndryshme: Thashë se barra e provës për entitetet, energjitë apo tipet e ngjarjes për të cilat ne s'kemi asnjë ide dhe asnjë provë të dukshme se ato ekzistojnë bie mbi personin që sugjeron që këto gjëra janë faktikisht të vërteta. Në të njëjtën kohë, unë po i referohesha përgënjeshtueshmërisë dhe mundësisë për të refuzuar disa argumente specifike. Unë iu referova përshkrimeve specifike të ndërhyrjes së Zotit në univers. Nëse ju më thoni se Zoti e bëri këtë, siç është përmbytja e Noes, për të cilën dr. Craig pranoi se duhet të ketë qenë ose jo-ekzistente ose një ngjarje lokale, atëherë, unë *mund* ta përgënjeshtroj atë. Pra, këto dy gjëra janë mjaft të ndryshme.

### Pyetja e Parë

#### Argumenti i Parë

Dr. Craig tha se nga premisat e tij rrjedh se shkaku përfundimtar i universit duhet të jetë i pakohë dhe i përveçëm, dhe ai pretendon se ky është një deklaram logjik që buron nga pakundërshtueshmëria. Përse? A keni menduar ndonjëherë përse shkaku i universit duhet të jetë i pakohë dhe i përveçëm? Vetëm sepse një filozof thotë se kështu është? Ç'dimë ne në lidhje me shkaku përfundimtar të universit? Unë mund të përfytyroj shkaqe të universit që nuk janë të pakoha dhe të përveçme. Unë nuk

kam asnjë problemi ta bëj këtë! Pra, ju duhet të bëni kujdes në të dalluarit e asaj që është faktike, e vërtetë, krejtësisht e pajtueshme me logjikën dhe asaj që në fakt është një supozim.

Dhe meqë jemi te konsequenca, Dr. Craig tha se qëndrimet e tij janë konsequente. Ndoshta janë. Ju mund të paraqitni një sërë sistemesh logjike konsequente që megjithatë nuk kanë të bëjnë aspak me realitetin. Ju e bëni këtë sa herë që luani një lojë kompjuteri. Ju krijoni një univers të tërë që është logjikisht konsequent, që ka rregulla dhe ka sjellje të parashikueshme, dhe ju mund të luani me të por ajo nuk ekziston në botën fizike. Pra, fakti se diçka është logjikisht konsequente nuk do të thotë se është e vërtetë. Janë dy gjëra krejtësisht të ndryshme. 'Fakti që diçka që është logjike duhet, për pasojë, të ekzistojë', është një argument me të meta.

### **Argumenti i Tretë**

Ne vazhdojmë të kapemi pas kësaj punës së moralit; a është objektiv apo s'është objektiv? Dr. Craig thotë se unë po them dëngla dhe po i kthehem pa reshtur qëndrimeve të mia. Unë nuk po i kthehem pa reshtur asgjëje. Po them vetëm se morali mund të ndryshojë, dhe, në fakt, po argumentoj se morali ndryshon më mirë sepse qëniet njerëzore, nevojat e qënieve njereëzore, dhe ajo çka ne duhet të vendosim, *vërtet* ndryshojnë. Pra, përse do të dëshironit një sistem që është krejtësisht i përcaktuar dhe i pamundur për t'u ndryshuar? Përse do të ndiqnit moralitetin apo rregullat që janë parashtruar nga njerëz që kanë jetuar 2 mijë apo 3 mijë vjet më parë? Më lejoni t'ju jap një shembull të thjeshtë që nuk ka të bëjë fare me krishterimin. Siç e dini, muslimanët e rreptë nuk hanë mish derri. Arsyeja për të mos ngrënë mish derri është shumë e mirë; vërtet, para shpikjes së ngrirjes ishte ide vërtet e keqe ngrënia e mishit në shkretëtirë, atje ku Muhamedi predikonte. Sot kjo s'është më e vërtetë për shkak të sendeve të quajtura frigorifer, ngrirës dhe gjëra të ngjashme. Sigurisht, shpeshherë vazhdon të jetë *E. coli* që mund t'ju zërë, por shumicën e kohës kjo gjë nuk ndodh. Ky rregull nuk ka më kuptim. Pra njerëzit vazhdojnë ta ndjekin këtë rregull prej traditës, e cila, sigurisht, është një arsye krejtësisht e respektueshme; ju mund të ndiqni të gjitha traditat që ju dëshironi. Por nuk është një vlerë objektive, një mënyrë e pa ndryshueshme e të sendërtuarit të realitetit. [b]

### **Argumenti i Pestë**

Në prekëm shkurtimisht këtë punën e përvojës personale. Epo, sigurisht, përvojat personale janë mjaft të rëndësishme. Ne bëjmë një mori gjërash me anë të përvojës personale. Të gjitha vendimet e përditshme në jetën tonë janë përvoja personale. Ne biem në dashuri; kjo është përvojë personale. Shumicën e kohës ajo nuk ka asfarë logjike. Problemi është se këtu ne po flasim për evidenca të pranueshme. Më vjen keq, por evidencat e pranueshme nuk i përmbajnë përvojat personale sepse përvoja personale mund të jetë e mirë për ty, por vështirë se mund t'i komunikohet gjithësekujt tjetër. Njerëzit që marrin drogë kanë gjithfarësoj përvojash, përvoja që unë jam i sigurtë se ju s'do t'i ngatërronit me realitetin.

Më lejoni ta mbyll duke thënë se shpresoj që sonte të gjithë ne kemi mësuar shumëçka nga dr. Craig, dhe unë dua t'ju falenderoj juve dhe ta falenderoj atë për këtë. Shpresoj se në të ardhmen do të ketë një mirëkuptim më të madh dhe një të menduar më të madh në mesin e të gjithëve ne mbi këtë çështje shumë të rëndësishme që ne kemi trajtuar sonte.

### **Përktheu: Ariol Guni**



Shën.përkthyesit:

a) Non sequitur –mosvazhdimësi, nga latinishtja.

b) Duhet se arsytet përse myslimanët nuk konsumojnë mishin e dërrit nuk janë kryesisht higjienike, por etike dhe religjioze.

### Shënime të autorit

1 Massimo Pigliucci, [“God as a Falsifiable Hypothesis”](#).

2 David Hilbert, “On the Infinite,” in *Philosophy of Mathematics*, redaktuar me një hyrje nga Paul Benacerraf dhe Hillary Putnam (Englewood Cliffs, N.J.: Prentice-Hall, 1964), fq. 139, 141.

3 Fred Hoyle, *Astronomy and Cosmology* (San Francisco: W.H. Freeman, 1975), fq. 658.

4 Anthony Kenny, *The Five Ways: St. Thomas Aquinas’ Proofs of God’s Existence* (New York: Schocken Books, 1969), fq. 66.

5 Stephen W. Hawking, *A Brief History of Time* (New York: Bantam Books, 1988), fq. 123.

6 P. C. W. Davies, *Other Worlds* (London: Dent, 1980), fq. 160-161, 168-169.

7 Në fakt, ilustrimi është sërisht nga Davies. Por për një konspekt të këtyre shembujve të rregullimit të imtësishëm shiko John Barrow dhe Frank Tipler, *The Anthropic Cosmological Principle* (Oxford: Clarendon Press, 1986).

8 Paul Davies, *The Mind of God* (New York: Simon & Schuster: 1992), fq. 16.

9 Fred Hoyle, “The Universe: Past and Present Reflections,” *Engineering and Science* (November, 1981), fq. 12.

10 Robert Jastrow, “The Astronomer and God,” në *The Intellectuals Speak Out about God*, redaktuar nga Roy Abraham Varghese (Chicago: Regnery Gateway, 1984), fq. 22.

11 Michael Ruse, “Evolutionary Theory and Christian Ethics,” në *The Darwinian Paradigm* (London: Routledge, 1989), fq. 262-269.

12 Fatkeqësisht, unë nuk kam qenë në gjendje të gjej artikullin nga ku është nxjerrë ky citim.

13 Jacob Kremer, *Die Osterevangelien—Geschichten um Geschichte* (Stuttgart: Katholisches Bibelwerk, 1977), fq. 49-50.

14 D. H. Van Daalen, *The Real Resurrection* (London: Collins, 1972), fq. 41.

[15](#) Gerd Lüdemann, *What Really Happened to Jesus?*, përkthyer nga John Bowden (Louisville, Kent.: Westminster John Knox Press, 1995), fq. 8.

[16](#) Luke Timothy Johnson, *The Real Jesus* (San Francisco: Harper San Francisco, 1996), fq. 136.

[17](#) N. T. Wright, "The New Unimproved Jesus," *Christianity Today* (September 13, 1993), fq. 26.

[18](#) James 4.8.

[19](#) John Barrow dhe Frank Tipler, *The Anthropic Cosmological Principle* (Oxford: Clarendon Press, 1986), fq. 561-565.

[20](#) Stephen Hawking dhe Roger Penrose, *The Nature of Space and Time*, The Isaac Newton Institute Series of Lectures (Princeton, N. J.: Princeton University Press, 1996), fq. 20.

[21](#) Peter Haas, *Morality after Auschwitz: The Radical Challenge of the Nazi Ethic* (Philadelphia: Fortress Press, 1988).

[22](#) John Barrow dhe Frank Tipler, *The Anthropic Cosmological Principle* (Oxford: Clarendon Press, 1986), fq. 133.

[23](#) Paul Davies, *The Mind of God* (New York: Simon & Schuster, 1992), fq. 169.

[24](#) Zbulesa 1.10, 12, 18, 21, 25, 31.

[25](#) Fjalët e tyre të sakta janë: "është zhvilluar një consensus i përgjithshëm në mesin e evolucionistëve se evolucioni i jetës inteligjente, e krahasueshme në aftësinë e përpunimit të informacionit me atë të *homo sapiensit*, është kaq e pamundur saqë nuk ka gjasa që të ketë ndodhur në ndonjë planet tjetër në të gjithë universin e dukshëm" (John Barrow dhe Frank Tipler, *The Anthropic Cosmological Principle* [Oxford: Clarendon Press, 1986], fq. 133).

**Date Created**

16/10/2014

**Author**

erasmusi